



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

KATEDRA E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

VLERA SIMBOLIKE E MITIT NË ROMANIN “KUSH E SOLLI DORUNTINË”

Punim magjistrature

KANIDIDATI

Anita Behluli:

MENTORI:

Doc.dr. Meral Veseli

Shkurt, 2020

Abstrakti në shqip

Kush e solli Doruntinën është një nga legendat më të vjetra të folklorit shqiptar ku i thuren lavde besës së dhënë, të cilën s’e tret as dheu. Ismail Kadare e merr këtë legjendë dhe ndërton me të një triller tërheqës. Ardhja e Doruntinës me kalin e Kostandinit merret si motiv kryesor për trillerin, të cilin ka për detyrë ta zgjidhë kapiten Stresi. Mitologjikisht, Doruntina dhe Kostandini duket të përfaqësojnë në mënyrë ideale çiftet inçentuoze vëlla- motër të romantizmit, por Kadareja e hedh poshtë këtë version, duke e bërë lexuesin që të kërkojë fajtorin e ardhjes së Doruntinës në gjurmët që lë Stresi. Personazhet kryesore janë Doruntina dhe Stresi, ndërsa nëna dhe Kostandini janë pika lidhëse që ngre në këmbë tragjedinë dhe misterin e të gjithë veprës. Ajo çka përbën rëndësi të veçantë për analizën tonë është lidhja e Doruntinës me të vëllain dhe me Stresin. Siç është përmendur te veprat e tjera, burri dhe vëllai janë dy shënjes të rëndësishëm të jetës së një gruaje. Marrëdhënia e saj me Kostandinin është një lidhje gjaku që kapërcen çdo kufi imagjinar; konteksti mitik kërkon që besa të respektohet dhe Kostandini të vijë me të nëna, por realja e lufton çdo mundësi që kjo të ndodhë.

Abstract

“Who brought Doruntina” is one of the oldest legends of Albanian folklore and where they praise the given faith, which is not wasted on earth. Ismail Kadare takes this legend and builds with him an attractive thriller. The arrival of Doruntina on the horse of Constantine is taken as the main motive for the thriller, which is tasked with resolving Captain Stress. Mythologically, Doruntina and Constantine seem to ideally represent the brother-sister-in-law of romanticism, but Kadare rejects this version, prompting the reader to look for the culprit of Doruntina's arrival on the trail of stress. The main characters are Doruntina and Stress, while Mother and Constantine are the connecting points that heighten the tragedy and mystery of the whole work. What is of particular relevance to our analysis is the connection of Doruntina to her brother and to Stress. As mentioned in other works, husband and brother are two important markers of a woman's life. Her relationship with Constantine is a blood relation that transcends every imaginary boundary; the mythical context requires besa to be respected and Constantine to come with his mother, but the real one fights any possibility of this happening.

Hyrje

Fillimisht mund të themi se interesimi shkencor është letërsia moderne, letërsia bashkëkohore, romani, Ismail Kadareja. Herët jam njohur me letërsinë, dhe ngritja arsimore ka qenë pikërisht brenda kësaj fushe. Kisha exuar romanet, por dhe i rilexova, konkretisht romanin *“Kush e solli Doruntinen”*. Nuk di pse e kisha zgjedhur pikërisht këtë roman, ndoshta kureshtjen ma kishte zgjuar titulli i romanit, që më është dukur më i kapshëm. Nuk kam pasur idenë se ç’mund të ndodhte, por që nga momenti që kam lexuar atë roman, parasysh më është krijuar një botë e tërë shqiptare, me gjithë përbërësit e saj, që nga mitet e deri të rrëfimi. Me një fjalë, diçka në mes tokës e qiellit, gati hyjnore, ku *besa*, fjala që më bënte të studiojë, sematikën, vlerën dhe imazhin kulturor që e jep ajo. Që nga ai moment, e gjatë gjithë jetës sime, Kadareja ishte shumë i rëndë dhe shumë i madh për mua.

Aty, duke debatuar, duke folur dhe përfolur për letërsinë, duke organizuar ligjëratat, formësohej përherë e më shumë kërkesa për ta studiuar më gjerësisht. *“Kush e solli Doruntinen”* më ka bërë përshtypje shumë, më tërhoqi fillimisht titulli i këtij romani dhe fakti se e njihja disi rrëfimin romanesk me fuqi krejt të veçantë simbolike të Kadaresë. Aq më tepër, që për një nga romanet e tij kam shkruar duke i dhënë vetes të drejtën, krejt subjektive, që ta interpretoj në një mënyrë të caktuar, pa dyshim të njëanshme. Lidhur me këtë roman, kisha thënë, se tragjizmi i kësaj bote qëndronte, sipas romancierit tim të preferuar, edhe te fakti se ikën nga simbolika e ndërtuar me lëndë empirike realiste dhe na tërheq bukur, thjesht, ëmbël, në një rrëfim ku përzihen ngjarje, ndodhi, peizazhe realiste, me përfytyrime të praktikave mitike, në një botë ku misterit dramatik përzihet me seksin -incestin, jeta dimërore e kullës zhytet në një mjegull të paparë marrëdhëniesh magjie, personazhet bartin një peshë kuptimore dhe një karakterizim psikologjik, që i vendos ata nën një tension dramatik të lëvizshëm.

Duke u marrë me këto tema, doemos edhe me romanet e Kadaresë, mësova për praninë e mendimit të lirë, që po bëhet karakteristikë e vlerësimit të kësaj letërsie. Gjithsesi duhet ndihmë e mentorit, dhe kjo nuk ka munguar. Kjo ndihmë erdhi përmes rekomandimesh të shpeshta, vërejtjeve, këshilla, orientimeve metodologjike. Kjo edhe është magjia e studimit të veprave të letërsisë sonë. *“Bota e Ismail Kadaresë është një lloj anti-materie. Ajo mund ta shkatërrojë*

tonën. Vetëm se ndryshe nga ç'ndodh me grimcat elementare në fizikë, bota e tij plotëson tonën duke lënë gjurmë të jashtëzakonshme".¹

Krijimtaria prozaike apo thënë më mirë romanore e Ismail Kadaresë fokusohet kryesisht te dramat ekzistenciale të popullit shqiptar, i cili nëpërmjet lidhjes me tokën, familjen, kodeve të tij tradicionale dhe identifikuese, arrin që të sigurojë mbijetesën përballë rreziqeve të njëpasnjëshme nga pushtuesit që vijnë në formë clirimtarësh, nga armiqtë të jashtëm e të brendshëm. Drama e ndërtuar mbi fjalën e dhënë është kod në letërsinë shqipe.

Vepra e tij është e ndërlidhur gjithnjë me poetikën e vendlindjes, poetikën e udhëtimit. Vendlindjen e cila jepet si Shqipëria, dhe udhëtimit përmes poetikës së udhëtimit të Konstantinit dhe Doruntinës. Ai te vendlindja e tij, qyteti i gurrte ndjehet më i kompletuar dhe nuk dëshiron të dalë jashtë kësaj bote, të cilën e transformon në mënyrë artistike. Në këtë mënyrë ai e shkruan një roman me vazhdime.

Ismail Kadare ka huazuar tema nga historia, folklori, baldata, miti, aq sa i është nevojitur për të sajuar botën e tij narrative. Ato i ka risemantizuar. Ka rrëfyer jo një histori të shkruar, por një histori të fiksuar në kujtesën kolektive.

Ky punim është një sipërmarrje e vështirë hulumtuese, për një autor të madh, ndoshta ndër të rrallët që në gjysmën e dytë të shekullit XX, i cili u shmang dukshëm “nga rreshti” i asaj metode hibride, të gjymtuar dhe të idealizuar që quhej “realizëm socialist”. Kadareja për mendimin tim ka shkëlqyer në prozë dhe veçanërisht në prozën e gjatë, romanin, këtë gjini të shpikur enkas për të, duke u bërë kështu ndër romancierët më të mirë të letërsisë shqiptare dhe botërore. Studimi i tipologjisë së personazheve në romanet e shkrimtarit bashkëkohës Ismail Kadare është punë e vështirë, sepse është problem të gjesësh përgjigje të palëkundura pyetjeve që ngërthen në vetë një temë e tillë. Nuk mund të themi se kemi një mungesë studimesh lidhur me prozën e Kadaresë por, detyrimisht përpjekjet e reja shkencore do ta plotësojnë mozaikun shkencor dhe do të shërbejnë si pikë referimi për studiuesit e ardhshëm të veprës së pashterruar kadareane. Është e pamundur nga një studiues letërsie të shterret e tërë lënda shkencore por një studiues i mirëfilltë vetëm mëton që studimi i tij të jetë gjithëpërfshirës, t’i përmbahet objektit të studimit, t’i rri besnik metodës së zgjedhur hulumtuese dhe të besojë në atë që e thotë edhe Umberto Eko, se vepra letrare mbetet një strukturë e hapur për interpretime dhe lexime të reja.

¹ Revista letrare, *Jeta e re*, nr 2, viti XLII, Prishtinë, 2011, f. 6

Horizonti i pritjes për veprën e Kadaresë do të jetë gjithmonë i hapur, për aq kohë sa ka lexues të saj për aq kohë do të ketë interpretues...

Të besosh te letërsia do të thotë të besosh në një realitet superior. Të besosh te letërsia do të thotë që regjimi i frikshëm i vendit tënd të të duket shumë më i zbehtë se funebriteti madhështor i saj. Të besosh te ky art do të thotë që ti të jesh i ndërgjegjshëm që qeveria që ty të sundon, që policia që ty të përgjon, që parlamenti, shefat, administrata, vetë tirania, nuk janë veçse një makth i përkohshëm, një lëndë e vdekur, në krahasim me urdhrin e madh, ithtar i të cilit je bërë ndërkaq.²

² Shpëputur nga fjalimi i Ismail Kadaresë me rastin e marrjes së çmimit *Man Booker International*, 2005.

The **Man Booker International Prize** është çmim letrar ndërkombëtar që jepet çdo dy vjet për autorë të gjallë të çfarëdo kombësie vepra e të cilëve është shkruar në anglisht ose është e përkthyer në anglisht. Çmimi ka vlerë monetare 60,000 pound. Ky çmim jepet nga viti 2005 dhe fitues i parë i tij është Ismail Kadare, i për zgjedhur në mesin e kandidatëve si: Margaret Atwood (Canada), Saul Bellow (Canada), Gabriel García Márquez (Colombia), Günter Grass (Germany), Milan Kundera (Czech Republic), Stanisław Lem (Poland), Doris Lessing (UK), Ian McEwan (UK), Naguib Mahfouz (Egypt), Tomas Eloy Martinez (Argentina), Kenzaburo Oe (Japan), Cynthia Ozick (US), Philip Roth (US), Muriel Spark (UK), Antonio Tabucchi (Italy), John Updike (US) dhe A.B. Yehoshua (Israel).

LËNDA E HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit do të nisët nga romani i vetëm i marrë për studim “*Kush e solli Doruntinë*”. Është roman i veçantë, një roman i çliruar nga dogma dhe një roman modern të ditëve të sotë mund të krijojmë gjykim për një vlerën të përgjithshme të letërsisë së kësaj periudhe ku kishte krizë shkrimi i romanit po aq dhe mungesën e strategjisë së studimit të romanit. Studimi, do të fokusohet te vlera mitik dhe reale e personazheve. Pa personazh nuk ka tekst, thotë një studiues. Personazhi është si vena që bart gjakun brenda një veprë. Personazhi është i rëndësishëm dhe kur autori flet përmes tij. E njohur është e dhëna e Kadaresë në kuadër të shkrimit të romanit, i rikthet mitit. Romanin në fjalë, do ta studiojmë duke u ndalur në mënyrë të veçantë te mitet, si studiohen mitet, legjendat, cili është funksioni i legjendës së ringjalljes, shmangie nga dogma e realizmit socialist, elementi i mitit, real dhe imagjinar, motivi i Besës, a ka ngjashmëri dhe cilat janë ato mes baladës së ringjalljes së letërsisë gojore arbëreshe dhe romanit. Do të studiohet ndërthurja e subjektit, zhvillimi narrativ, do të tentohet t’i jepet përgjigja misterit të sjelljes së Doruntinës në shtëpinë e babait. Do të ndalemi po ashtu në kategorizimin e personazheve, të gjuha e tyre, për të përmbyllur në fund me rëndësinë dhe vlerën që ka romani për letërsinë e sotme shqipe.

Përzgjedhje do të behët duke marrë referencë fjalën e kritikës bashkëkohore, studimet e rralla për autorë dhe vepra, dhe duket i fokusuar dijet mbi kategorinë e personazhit, si: lënda hulumtuese, elementet e mitit në roman, si studiohet miti në letërsinë, etj.

Si studiohet personazhi? Cili personazh mund të paraqesë tipin? Janë të njohur dhe të përkthyer fatmirësisht studimet e Filip Hamonit, për personazhin, mbase janë të dhëna të rralla teorike për këtë strukturë të rëndësishme të prozës pa të cilin nuk behët romani, pa personazh nuk ka prozë... Ai thotë se: kjo kategori estetike (e personazhit), mund të jetë me funksion të përdorimit problematik, më pak përshkrues, d.m.th interpretues, (apo mbi-interpretues), kur ajo (kategori), si e tillë, aplikohet për veprat e mëparshme që mbajnë shenjën e paradigmes së romanit "realist" të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shpesh e favorizuar nga teoricienë me konceptimin, ajo përcjell një seri të tërë të supozimeve, veçanërisht në aspektin e analizës

psikologjike, krejtësisht të huaj për letërsinë antike dhe klasike. Përmendja thjeshtë e "karakterit" apo "personazhit", mund të jetë, në fakt, një anakronizëm për tekstet antike dhe klasike.³

Në aspekt të teorisë së letërsisë siç përshkruan Solari, **personazhi** (lat. *persóna* – *person*, individ, protagonist) – është bartësi kryesor i veprimit në veprën letrare. Ai është mishërim (inkarnim) i vetive morale, ideore, ndijesore të një individi në veprën letrare, pra, përfshin në vete një grumbull të veçorive, të cilat e bëjnë individin njerëzor dhe sipas së cilave ai dallon nga njerëzit e tjerë. Në lidhje me personazhin ndeshim edhe në nocione të tjera si: figurë, hero, karakter, tip, portret. Të gjitha këto nocione përdoren në kuptimin e tyre të gjerë ashtu që mund ta zëvendësojnë ndërsjellshëmrisht njëri-tjetrin. Në disa formacione letrare, si: në letërsinë antike, mesjetare, të renesancës dhe atë klasikiste, personazhi ka shërbyer shpesh si stilizim i përgjithshëm vetëm për disa tema të caktuara, dhe nuk janë dhënë veçoritë individuale të tij.

Kështu, te "Karakteret" e Teofrastit (shekulli III para erës sonë), personazhi paraqitet në formën e definicionit të ndonjë vesi (ceni), pas të cilit vjen përshkrimi i të folurit dhe sjellja e atij njeriu, të cilin e përcakton vesi i tillë. Në këtë formë të përgjithësuar, edhe pse jo gjithmonë në formën e tillë të skematizuar, personazhi konstituohet në përrallëz, alegori, moralitet, si dhe te pasardhësit klasikistë të mëvonshëm të Teofrastit (La Brijer, A. Poup). Edhe në këto vepra personazhi shpesh ka një specificitet psikologjik dhe shoqëror, por vetëm në letërsinë e re evropiane, sidomos në dramën dhe në romanin e renesansës së shekujve XVIII, XIX dhe XX, ky specificitet psikologjik, individual dhe shoqëror bëhet aq i rëndësishëm dhe aq shprehës sa që personazhi letrar nuk paraqet më ilustrimin e ndonjë teme të një rëndësie të përgjithshme sesa.?? shprehjen e preokupimit të shkrimtarit me një lloj të fatit individual njerëzor.

Autori i huaj i njohur për studimet e romanit, Albert Thibaudet thotë: "*Romancieri i vërtetë krijon personazhet e tij me drejtime të pafund në jetën e tij të mundshme, romancieri krijon model me një linjë të vetme nga jeta e tij e vërtetë. Historia e vërtetë është një autobiografi e mundshme (...) gjeniu i romanit na bën të jetojmë të mundshmen, pa e zbuluar të vërtetën.*"⁴

³ Hamon, Philippe, *Pour un statut sémiologique du personnage*, in R. Barthes, È. Kayser, È.C. Booth & Ph. Hamon, *Poétique du récit*. Paris : Seuil, coll. "Points Essais", 1977, p. 115-180 (version remaniée de l'article publié en 1972 dans *Littérature*, 6, Paris).

⁴ Albert Thibaudet, *Réflexions sur le roman*, "Gallimard", 1965 - *Literary Criticism*, fq. 257.

Hulumtimi ynë do të bazohet në dy hapësira, të cilat e karakterizojnë botën shpirtërore të shkrimtarëve (nëpër dy kohë të ndryshme), por që *“ekziston edhe një kontekst historik social e psikologjik si rrjedhë e brendshme” e zhvillimit të letërsisë.*⁵

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Më saktë, qëllimet e hulumtimi i kemi të ndara për ta parë relievimin dhe konfigurimin komentues të autorit, veprës, personazhit dhe rrëfimitarit, si edhe për të parë elementet mitike, mitin e besës, elementet baladeske dhe legjendën e njohur arbëreshe.

Qëllimet e studimit janë disa dhe ndër to përfshire shndërrimet e miteve etnoreligjioze në mite letrare – rimarrjet në veprën e Ismail Kadaresë, të cilat janë të organizuara sipas një rregulli të caktuar, në mënyrë të ndërgjegjshme e të pandërgjegjshme dhe duke ndërtuar lidhje të rëndësishme, marrëdhënie specifike midis tyre dhe qëllime të caktuara estetike, formojnë një sistem të veçantë.

Qëllim i studimit tonë është gjithashtu, lënda e gjerë studimore dhe zbrazëtia në studimet e krahasuara në kontekstin shqiptar, kjo është një tjetër arsye për ndërmarrjen e kësaj pune titanike. Nëse do të bëhej një paraqitje e shkurtër, do të shihej kjo çështje mbi studimet shqiptare, kryesisht në dy drejtime: në kontributin e dhënë për mbledhjen e folklorit (miteve, legjendave, përrallave, gojëdhënave) si dhe në kërkimin për studime të krahasuara të kësaj natyre ndër studiuesit shqiptarë. Natyrisht, natyra e punës nuk është e njëjtë, po ashtu, ka shumë pak ngjashmëri në rezultate dhe interesimi për studimet e krahasuara ka nisur tepër vonë.

⁵ *Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare* (Nga gjysma e dytë e shekullit XX –poezia, proza, drama) ASHAK, Prishtinë, 2005, Floresha Dado: kumtesa “Probleme metodologjike të letërsisë së sotme”, f. 17.

HIPOTEZAT

Të hulumtohet vlera e përgjithshme e mitit të besës, mitit të ringjalljes, në romanin e marrë për studim *"Kush e solli Doruntinën"*, Do të hulumtohet dhe sfida e romanit përballë intertekstit mitik, personazhit mitik, miti shqiptar dhe ai grek, analogji dhe afri lëndore, metodat e reja të studimit të romanit, njohja e thellë e personazhit, paraqitja e tipologjisë së tyre sipas një renditje origjinale dhe mbi bazë të vlerës gjuhësore, stilistike, diskursit të personazhit, etj.

Hipoteza e parë: të hulumtohet personazhi mitik,

Hipoteza e dytë: të hulumtohet personazhi i udhëtarit të vdekur që çohet nga varri.

Hipoteza e tretë: të hulumtohet dhe të bëhet analizë krahasuese e miti në relacion me personazhin e Kadaresë.

Hipoteza e katërt: të zbulohet interteksti, i cili paraqitet si mozaik tekstesh në këtë radhe me tekstin e mitit shqiptar dhe atij grek.

Mitologjia dhe letërsia bashkëkohore kanë marrëdhënie ndërvepruese, siç duhet vepruar me historinë për të mbërthyer parahistorinë, në të njëjtën mënyrë duhet nisur nga tekstet ose traditat letrare të cilave i përqasemi me hipoteza mbi atë që e ka paraprirë.

Pyetja se kush e solli Doruntinën hap disa pista hetimi e interpretimi, duke nxjerrë dyshime në nivel enigme e mister, ndonjëherë versionesh të papritura e të habitshme, që tërheqin tutje hipoteza dhe përfundime të ndryshme. Po këta elemente i japin punimit vlerën shkencore.

METODAT E PËRDORURA PËR HULUMTIM

Gjatë shkrimit të këtij punimi do të përdoren këto metodat shkencore;

1. Metodën teorike, do të analizohet teoria e intertekstit si edhe do të shqyrtohet kjo teori në raport me mitin;
2. Metodën komparative (krahasuese), do të krahasohet vepra në shumë dimensionë me elementet me të cilat do të ketë kryqëzime;
3. Metodën deskriptive, me përshkrimet dhe analizat e personazheve që paraqiten si parësor dhe krijojnë trekëndëshin ideal siç janë: Stresi, Doruntina Kostadini;
4. Metodën analitike, do të bëhet analiza e romanit në bazë të stilit, gjuhës dhe diskursit që përdoret në veprën letrare “*Kush e solli Doruntinën*”.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Vlera mitike dhe reale e personazheve të romanin “*Kush e solli Doruntinën*” synon të jetë një punim origjinal, duke pasur parasysh faktin se romanet e Kadaresë janë të studiuara, po qasja jonë në këtë punim shkencor do të jetë ndryshe. Studiues si Viola Isufaj, dhe disa të tjerë e kanë studiuar mitin te Kadareja, dhe brenda studimit ka dhe gjetje, të cilat i shohim të nevojshme për t’iu referuara. Sythi që ka të bëjë me mitin se kush e solli Doruntinën është një shembull i studimit në letërsinë tonë dhe kritikën letrare. Studime preferenciale dhe për analogji, do merren dhe ato të Mateo Mandalasë, dhe Francesco Altimarit, të cilën janë po ashtu modele studimi.

Rëndësia e këtij romani, është pikërisht te studimi i personazhit, i cili ka një botë të veçantë shpirtërore, në strukturën e tyre ka brumë mitik, karakterizimi i tyre nuk është i thjeshtë, gjuha e komunikimit të personazheve është e veçantë dhe e koduar, është mister që kërkon lexime të thella dhe ndihmë nga shkencat tjera, nga psikologjia, nga filozofia, mitologjia, imazhologjia.

KREU I PARË

I. KUSH ËSHTË ISMAIL KADAREJA – PORTRITI LETRAR

Ismail Kadare është i lindur në Gjirokastrë në vitin 1936 është shkrimtari më i popullarizuar shqiptar. Emri i tij i ka thyer muret e vorbës sonë kulturore dhe është bërë i njohur pothuaj në mbarë botën, aq sa me të drejtë është quajtur "*ambasador i letërsisë shqipe në botë*" dhe është folur për "*fenomenin Kadare*"; është cilësuar "*gjeneral i prozës sonë*" dhe "*korife i letërsisë së sotme shqipe*" etj. Vepra e Kadaresë në poezi dhe në prozë, ka zgjuar vazhdimisht vëmendjen e lexuesve dhe të kritikës letrare kudo në botë. Çdo libër i tij i botuar në disa gjuhë të botës, është mirëpritur me interesim të madh, bile me padurim, nga ana e adhuruesve të shumtë të fjalës së tij artistike. Ai hyn në radhën e atyre shkrimtarëve, jo aq të shpeshtë në kohën tonë, të cilët, me veprat e tyre, kënaqin edhe shijen e publikut të gjerë lexues, edhe shijen e kritikës elite letrare. Karrierën e vet letrare Ismail Kadareja e filloi si poet, për ta vazhduar më vonë si prozator, pa hequr dorë thuaja asnjëherë nga dashuria e tij e parë - poezia. Në vitin 1954, në moshën 18 vjeçare, kur ende ishte gjimnazist, botoi përmbledhjen e tij të parë, *Frymëzime djaloshare*. Ishte ky një libër i vogël me vjersha të lehta e shumë herë naive, ku nuk mungonin shenjat që paralajmëronin talentin e ardhshëm, i cili u duk akoma më mirë tre vjet më vonë në vëllimin *Ëndërrime*, me të cilin poeti, edhe pse nuk ishte çliruar ende nga dobësitë dhe kufizimet fillestare, bëri një hap përpara në formimin e individualitetit të tij krijues.

Ndonëse nuk mund të mohohet rëndësia e tyre për lindjen dhe formimin e talentit të ardhshëm, vëllimet e para të Kadaresë shënojnë fazën e belbëzimeve krijuese të këtij autori, fazën e "frymëzimeve" dhe të "ëndërrimeve" të tij djaloshare. Me vëllimin e tretë, *Shekulli im*, të botuar në vitin 1961, poezia e Kadaresë hyn në një fazë të re, në fazën e kërkimeve novatore dhe të pjekurisë së vet artistike. Në studimin e tij *Poetnovator*, që është ndër punimet më të plota të shkruara për poezinë e I. Kadaresë (kritika jonë në përgjithësi është marrë më shumë me prozën sesa me poezinë e tij), R. Brahimi pohon se vitet 1958-1961 kanë qenë për poetin "vitet e vrullit". Talenti i Ismail Kadaresë, i pranishëm edhe në dy vëllimet e mëparshme, shpërtheu

plotësisht në vëllimin *Shekulli im*, me të cilin poeti inauguroi fazën e kërkimeve poetike novatore në poezinë shqipe. Me një zemërim të thellë futurist, thuaja të paparë në letërsinë shqipe, ai ngrihet kundër konvencionalitetit në poezi, kundër gjithçkaje të vjetruar, sentimentale e konservatore në jetë dhe në art.

Kadareja bëri emër së pari si poet, e pastaj u afirmua edhe si prozator. Në kohën kur e botoi romanin e tij të parë, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, me të cilin ky shkrimtar yni "pushtoi" tërë botën (*Gjenerali...* i tij është përkthyer në më se 30 gjuhë), kritika letrare në Shqipëri shkruante për të si për *prozën e një poeti*.⁶ Lexuesit shqiptarë (ata të vendit) e njihnin atë deri në atë kohë kryesisht apo vetëm si poet, kurse lexuesit shqiptarë në Kosovë nuk e njihnin fare ose sapo kishin filluar ta njihnin. Në vetëdijen dhe përfytyrimin e lexuesve shqiptarë të viteve '60 Ismail Kadareja (asokohe 20 e sa vjeç) ishte poeti, i cili i kishte luhatur seriozisht themelet e poezisë së vjetër, "të deklasuar", të poezisë anemike tradicionaliste, që qëndronte, disi larg jetës së gjallë dhe kohës së vet dinamike. Ishte poeti, i cili sillte në poezinë shqipe një frymë të re, "frymën e kohës", duke portretizuar fytyrën e atdheut socialist dhe fizionominë e njeriut me botëkuptim të ri, si edhe ritmin dinamik të shekullit XX dhe të atmosferës së tendosur në botë, kur "*Përleshjen e shkullen për flokësh si gratë agjensitë e lajmeve*".⁷

Përderisa në vitet '50-'60 ritmi i botimeve të Kadaresë në poezi është mjaft i shpeshtë dhe shkon në favor të veprave poetike (*Shekulli im*, *Përse mendohen këto male*-1964, *Vjersha dhe poema të zgjedhurave*-1966, *Motive me diell*-1968 etj.), duke filluar nga vitet shtatëdhjetë e këndeaj ai do t'i kushtohet kryesisht prozës, duke botuar romane, novela, vëllime me tregime etj. (*Gjenerali...*, *Dasma*, *Kështjella*, *Kronikë në gur*, *Dimri i vetmisë së madhe*, *Nëntori i një kryeqyteti*, *Dimri i madh*, *Emblema e dikurshme*, *Pashallëqet e mëdha*, *Prilli i thyer*, *Kush e Solli Doruntinën*, *Koha e shkrimeve*, *Koncert në fund të dimrit* etj.) dhe vetëm një vëllim me poezi, vëllimin poetik *Koha*-1976.

Lidhur me këtë çështje, domethënë lidhur me raportin midis gjinive - midis poezisë dhe prozës - vetë autori në një rast thotë:

⁶ Titull i një recensionit të Razi Brahimit për romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Në librin *Shënime letrare*, Tiranë 1965, f. 255-271.

⁷ Ismail Kadare, *Motive me diell*. "Naim Frashëri", Tiranë 1968, f. 57.

"Gjinitë e mia më të preferuara mbeten romani dhe poezia. Është e vërtetë që kam shkruar tepër rrallë poezi vitet e fundit, por kjo s'më pengon aspak që ta vë poezinë ndër dy pasionet e mia kryesore të krijimit. Pastaj, ta lërosh poezinë, kjo s'do të thotë ta shkruash atë në formën e saj të mirëfilltë. Poezinë mund ta shkruash edhe në stofin e veprave të gjinive të tjera".⁸

Kjo do të thotë se Ismail Kadareja si shkrimtar përpiket ta zhdukë kufirin rigoroze e shumë herë artificial ndërmjet poezisë e prozës, i bindur se poezia dhe proza janë, siç thoshte Rabindranat Tagora, *"motra e jo re e vjehërr"*.

Kadareja u afirmua së pari në suaza kombëtare (në kuadër të vendit dhe të gjuhës së tij), e pastaj në relacione ndërkombëtare, duke dëshmuar kështu më së miri tezën e vjetër se asnjë shkrimtar e artist nuk mund t'i takojë botës, nuk mund t'u takojë të tjerëve, pa i takuar më parë vetvetes, të vetëve.

Ismail Kadare botoi deri më sot më se 30 vepra në poezi e prozë, shumica e të cilave janë botuar e ribotuar nga disa herë, kurse së bashku me përkthimet në gjuhë të huaja, të cilat nuk janë pak dhe për të cilat nuk kemi një pasqyrë të plotë,⁹ ato mbushin një bibliotekë të tërë.

Veprat letrare e Ismail Kadaresë paraqet sot një nga korpuset më të rëndësishme të letërsisë shqipe, ndërsa poezia në kuadër të saj - një vatër interesante kërkimesh, pikëpamjesh, konceptesh e vlerash letrare artistike.

Leximi i romave të Kadaresë është një përpjekje për të kuptuar, për të bashkëjetuar dhe për t'u ushqyer shpirtërisht nga një shkrimtar dhe mendimtar origjinal dhe i shkëlqyer. Veprën e tij duhet ta konceptojmë si një sistem apo strukturë shenjash, që i shërben një qëllimi specifik estetik, ta analizojmë si nga aspekti përmbajtjesor, aspekti imazhologjik dhe kulturologjik, që idetë, emocionet që na përcjell personazhi, pra elementet më tipike nëpërmjet të cilave shprehet një tipologji unike e cilë të përfton me plot delikatesë për ti takuar plotësisht. *Asnjë fushë dhe*

⁸ Ismail Kadare, *Poezia është e pranishme kudo*. Intervistë dhënë revistës "Ylli", Tiranë 1979, nr. 1, f. 2.

⁹ Një informacion mjaft të plotë përkitazi me botimin dhe pranimin e veprave të I. Kadaresë në Francë na jep Y. Jaka në librin, *Lidhjet letrare shqiptaro-frënge* (1979), mirëpo vetëm deri në vitin 1973. Do të ishte mirë që kjo punë të vazhdohej edhe për më vonë, madje jo vetëm për regjionin gjuhësor francez, por edhe më gjerë.

*asnjë lloj gjendjeje shpirtërore nuk është e huaj për gjeninë krijuese të Ismail Kadaresë, që është pa dyshim shkrimtari më i begatë dhe më i larmishëm i kohës sonë.*¹⁰

KREU I DYTË

II. RIKTHIMI I MITIT TE KADAREJA – “KUSH E SOLLI DORUNTINËN”

Kadareja rimerr mitin, i rikthehet madje shpesh. Rrëfimet *ndryshe* të cilat ndërtojnë një poetikë jo socrealiste në romanet e shkruar pas viteve 90-të të Ismail Kadaresë të krijojnë mundësinë që të interpretosh një poetikë të mirëfilltë letrare, një poetikë të vendlindjes, një poetikë të hapësirës, një poetikë të udhëtimit, një poetike me interteksti mitik, por assesi një poetikë komuniste... *Shkrimtari që kishte guxuar të kërkonte frymën e Evropës në botën e shkëlqimtë arbërore të mesjetës së rilindëse të Evropës, me Kush e solli Doruntinën, Prillin e thyer, Urën me tri harqe, në vend të pasaportës së asaj epoke, statuteve dhe rregulloreve evropiane, zgjodhi të drejtën kanunore, për të përvecuar njeriun shqiptar.*¹¹

Po qëllimi ynë studimor është vetëm romani “*Kush e solli Doruntinën*”. Ka mendime se shkrimtari Ismail Kadare nuk e ka aspak vështirë të krijojë, pra aktin e krijimit. Ai ka krijuar vepra të mëdha, qoftë edhe duke e vënë në strukturën e tyre ëndrrën, duke e bërë të ligjërojë mitin, përrallën, siç edhe duke e futur në përbërësit e poetikës së romaneve të tij biseda kafenesh.

Përkufizimet për mitin janë të shumtë. Më duket i drejtë mendimi i Pol Valeri: “*Mit është emri i çdo gjëje që nuk ekziston, por është prezent duke u falënderuar fjalëve*”. Është fakt që mes mitit dhe asaj që quhet botë e artit ekzistojnë shumë gjëra të përbashkëta apo të afërta, fjala vjen, prania e elementëve fantastikë në vepër, imagjinata, shkrirja e tyre, të cilat, si të tilla janë të pandara nga përjetimet emocionale, dëshirat dhe synimet e personazheve që janë bartës të ngjarjeve në një vepër letrare. Megjithatë, dihet se arti dhe miti kanë edhe shumë gjëra që i largojnë. Në radhë të parë, dihet se “*miti është produkt i fantazisë kolektive, kurse arti është*

¹⁰ Alaian Bosquet, *Himn i shumëkuptimshmërisë* Revista letrare „*Jeta e re*“, nr 2, viti XLII, Prishtinë, 2011, f. 112.

¹¹ Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullin 20-të*, Naimi, Tiranë, f.224.

produkt i imagjinatës krijuese individuale”¹².

Fakti se mitet janë produkt i dalë nga vetë populli dëshmon për peshën që kanë në jetën e tij. Aq më interesant dhe më tërheqës bëhen kur të njëjtëve u gjejmë motërzimet e tyre, kurse në një vepër letrare ato ngrihen në art përmes përngjasimi dhe rrafsheve të ngjashmërive, ashtu siç bën dhe Kadareja jonë i madh në veprat e tij moderne. Pra, miti në bashkëjetesë me artin letrar modern, del se përveç që mundësojnë krijimin e veprave tërheqëse, janë edhe frytdhënëse. Për të dëshmuar këtë, mjafton që t’i hedhim një sy letërsisë greke, shtratin ku janë ngritur letërsitë e popujve evropianë, sepse “arti antik, sidomos ai grek, ka qenë i lidhur ngushtë me mitologjinë greke, bile edhe i pandarë nga ajo. Është e pamundur lexuesi i sotëm t’i kuptojë veprat e Homerit pa pasur njohuri mbi mitologjinë antike greke, meqë pothuajse gjysma e veprimit në “Iliadën” dhe “Odisenë” e tij zhvillohet në botën e Zotërave. Prandaj, mund të themi se mitologjia greke paraqet materialin, brumin, truallin e artit antik grek, ashtu siç miti shqiptar paraqet brumin e letërsisë shqiptare në përgjithësi, dhe në veprën e Kadaresë në veçanti.

Në vështrim të parë Kadareja shkruan kryekëput vetëm për Shqipërinë. Por ato ngjarje, që s’ia vlen të hedhesh sytë në anë të botës, ai i shndërron në letërsi botërore, shkruan kritikja gjermane e njohur për studimet letrare Anjez Hyfner.¹³

2.1 ÇKA NË TË VËRTETË ËSHTË MITI, MITI LETRARE, RISEMANTIZIMI I MITIT

Mit quhet një tregim fantastik i thurur rreth ndonjë dukurie të natyrës ose të jetës shoqërore. Fjala mit nënkupton gojëdhënë. Në bazë të gojëdhënave lindi mitologjia, të cilën e hasim te çdo popull i vjetër. S’ka letërsi që s’është e ndikuar nga letërsia e një populli tjetër. Zakonisht mbështetje të mëdha merren nga popujt fqinjë, por s’ka ndonjë popull që s’është ndikuar nga letërsia e vjetër greke përkatësisht mitologjia greke. Ndikime të tilla nga mitologjia greke vërehen sot gjithkund në letërsinë tonë bashkëkohore. Sapo dëgjojmë për mitin, automatikisht na asocon në legjenda, përralla apo diçka tjetër të ngjashme që është e rrejshme, e

¹²Mirlinda Krifca, *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave botërore*, f.65.

¹³ Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, f. 195.

shpikur, që bazohet në ndjenjat dhe fantazinë e njeriut. Mirëpo, sado i pavlefshëm që duket në shikim të parë, ngase thamë që s'ka të bëjë me gjëra të vërteta, miti ka pasur dhe vazhdon të ketë një rëndësi të madhe në letërsi. Madje miti mund të quhet shpirti binjak i letërsisë moderne pa të cilin vështirë se do të mbijetonte letërsia që kemi sot. Që nga kontakti i tyre i parë miti dhe letërsia bashkëkohore janë mjaft të varura nga mitologjia greke dhe, po të mos e shfrytëzonte mitologjinë si farë krijuese, mbase dhe s'do ishte kjo letërsi që është tani.

Mitet e lashta i gjejmë edhe sot në traditat popullore, këngët e legjendat popullore, ritet e ndryshme dhe jo vetëm. Mitet e lashta i gjejmë të pasqyruara edhe në romane të ndryshme të kohës moderne dhe ato janë bërë elemente bazë frymëzimi për krijimin e shumë veprave ose dramave.

2.3 SI STUDIOHEN MITET?

Studimi i miteve është një dukuri mjaft e gjerë dhe e vështirë, kërkon durim dhe sakrificë. Të studiosh mitet do të thotë të jesh njohës i mirë i folklorit, gjuhës dhe psikologjisë.

Studimi i miteve përmban në vete antikën, historitë e antikës, origjinën, natyrën dhe fenomenet e saj, heronjtë, zotërat dhe rituale të ndryshme.

Historitë me zotëra, me fuqi të mbinatyrshme dhe heronj janë krijuar mijëra vite më parë por mbështetja e tyre në art sot është jashtëzakonisht i madh. Të mbështetur nga mitet sot nuk shkruhen vetëm vepra artistike por realizohen piktura, skulptura, këngë e valle, krijohen filma të mëdhenj Hollivudian që pëlqehen dhe përkrahen nga publiku, shembull është filmi “*Game of Thrones*” seritë e të cilit ndiqen nga miliona shikues anë e mbanëglobit. Mbështet mbi motivin e baladës popullore ballkanike, të vëllait për të kthyer në gjini motrën e martuar larg “nëntë male kaptuar’.

2.4 MITI TE KUSH E SOLLI DORUNTINËN

Janë nëntë vëllezër që martojnë motrën në Bohemi, tutje thellë në Evropë, te popujt e fisme, të cilët duke e pranuar këtë krushqi behën aleatë të arbanëve, siç e quanin veten fiset shqiptare, për ballë rreziqeve të kohës. Doruntina është ambasadore e ditëve të sotme. Kërkon aleat për të forcuar pushtetin.

Kadareja i flet për një epoke të tashme nëpërmjet një epoke të largët.

1. *Mbështet mbi motivin e baladës popullore ballkanike*
2. *Ngjarja e periudhës së fundme bizantine*
3. *Një martesë e largët “nëntë male kaptuar”*
4. *Një krushqi për miq si forcim aleancash”*
5. *Një udhëtim nga juglindja në veriperëndim*
6. *Doruntina fli e interesave të vëllazërisë*
7. *Arbëria shihet në lidhje me një metropol*
8. *Fund tragjik për Doruntinën*
9. *Historia arbërore modernizohet*
10. *Bota shqiptare në një kontekst evropian*
11. *Autori shprehet përmes kapiten Stresit*

Përmes gjuhës metaforike-alegorike, i flasin kohës sonë, secilës kohë. Balada tregimtare: Konstandini dhe Doruntina (Motra dhe nëntë vëllezërit, Motivi i ringjalljes), tradita shqiptare, besa.

Pse i kthehet shkrimtari kësaj teme:

Sepse është:

1. Mit që ecë nëpër shekuj,
2. Hapësirë që mundëson lundrimin në këtë temë të misterit vdekje-jetë,
3. Vlerë e lashtësisë me emblemë antike,
4. Ushqim shpirti qoftë edhe në kriza shpirtërore,
5. Përmirësim i imazhit shqiptar para botës.

Rrëfimi përcjellës në dy këndvështrime

1. Amanetin se tretë dheu,
2. Ëndrra e parealizuar si incest më i fuqishëm se vdekja,
3. Doruntina u kthye në shtëpi,
4. U vu në vend fjala e dhënë.

Çështje të dorës së dytë

1.Kush ishte ai që mbajti besën ?

2.Me cilin u kthye Doruntina?

1980: Shqipëria 40 vjet izolim totalitar e katandisur në mjerim material dhe shpirtëror. Konstandini i vdekur, fryma dhe vizioni është gjallë në rrëfim. Këmbëngulja për largësi hapësinore, për të vënë pika komunikimi, Për të kërkuar vlera lashtësie, për të vënë në shërbim të së sotmes, si Eskili, Dante e Shekspiri ai flet me gjuhën e çdo shekulli në të ardhmen.

Shqipëria nën diktaturë jepte shpirt, venitej edhe fjala e dhënë, besa, virtyt kurorë, vlerë madhore, ka mundur ta ruajë gjallë bërthamën e qenies kombëtare.

Rrëfimi brenda dy rrjedhave :

1. Asaj që lëviz mbi peizazhin e gjallë (i përafërt me Prillin e thyer)
2. Misterit të Hadit (me hijedritat Diana - Gjorgu)

Stresi hetues i ngjarjes misterioze dhe zgjidhës i enigmës. Si detektiv. Me konstruksion shpirtëror dhe psikologjik të ekuilibruar, e ka të qartë se puna e ringjalljes është një përrallë. Se në periudha të caktuara krizash , trazojnë dhe krijojnë rrëmuje të fuqishme. Perspektiva hetuese përqendrohet në : **I GJALLI KA KALËRUAR ME TË GJALLIN**. Vonë do të bindet se nga një perspektivë dhe filozofi i gjalli dhe i vdekuri do të kalërojnë bashkë. Demitizim!.

Doruntinën e solli Konstandini. Kjo do t'i bëhet e qartë Stresit me biseda me miqtë e Konstandinit. Kjo është natyra komplekse e tij. Edhe Stresi i gjallë edhe Konstandini i vdekur, janë në një përjetësi. Doruntinën ka mund ta sjellë fryma e Konstandinit, si fanitje , ka mundur edhe pasuesi i tij i gjallë, qoftë edhe vet Stresi.

Kjo nuk ndryshon thelbin e baladës.

Stresi para se të japë dorëheqjen në praninë e këshillit të ipeshkvinjve pohon :
Doruntinën e solli Konstandini , besa.

Miti i besës dhe e kundërta, pabesia që i mundon shqiptarët “kompleks i Rozafës”: jo nderi fisnik, por kompleksi i tradhtisë (kur burrat para grave shpalosin marrëveshjen...)

2.5 MITI RELIGJIOZ DHE MITI LETRAR

Gjatë gjithë historisë së shkruar të njerëzimit vetëm tre njerëz janë ngritur nga varri: Jezu Krishti, Lazari dhe Konstandini.

Po ta studiojmë ngjarjen me këndvështrim religjioz do të shohim se ngjarja ka ndikim të drejtpërdrejtë të fesë së krishterë. Dita e Pashkëve është dita kur Jezu Krishti është ringjallur dhe pikërisht Ditë Pashkësh ka qenë edhe ditën kur nëna e Konstandinit shkon te varri i tij dhe e mallkon atë për besën që nuk e pati mbajtur. Në të njëjtën kohë Dita e Pashkëve përkon edhe me stinën e pranverës e cila njihet si stina gjatë së cilës çdo bimë, lule ringjallet, natyra ringjallet, shpirti ringjallet.

Po të flasim për periudhën e ngjarjes, do të vërejmë se mund të ketë qenë koha matriarkale (e kundërta e kohës patriarkale kur sundonte burri), kjo pasi personazhet kryesorë të veprës nuk janë Konstandini dhe vëllezërit e tij të vdekur, as babai i tyre i cili aspak nuk përmendet në vepër, por Doruntina dhe nëna e saj. Nga ky këndvështrim kjo ngjarje përkon me periudhën mes shekujve V- VI të erës sonë.

Fjala e dhënë dhe e mbajtur për hir të kultit të besës së shqiptarëve është edhe fjalë e mbajtur për hir të nënës, familjes. Rëndësia që autori i jep familjes duke e bërë prioritet është transformimi i kultit të lashtë të besës në modernizëm pasi në shoqërinë moderne familja është themeli i shoqërisë.

Ky element, familja, është shkaku se pse nëna fillimisht nuk donte ta martonte Doruntinën aq larg, pasi nuk do ta kishte për vaj dhe për gëzim pranë.

Element i ngjashëm me pjesën religjioze të mitit është edhe ngjashmëria mes zisë që mbante nëna pas vdekjes së Konstandinit me zinë që mbante Nëna Maria pas torturimit të Krishtit. Por

gjithsesi kjo nuk nënkupton se Konstandini është njësoj me Krishtin, pasi Krishti ka fuqi mbinatyrore, ai është shenjtë i dërguar nga Zoti, ndërsa Konstandini është njeri i thjeshtë me fuqi njerëzore.

Po të flasim për **numra religjiozë**, vërejmë se përmenden numri 9 (nëntë djem) dhe (nëntë male duhej kaluar për të arritur në Bohemi ku ishte martuar Doruntina) dhe numri 3 (kthim pas 3 vitesh martesë).

- Në Dhjatën e Re të Biblës ekzistojnë 27 libra, që domethënë

3 x 3 x 3 dhe përkojnë me Treshen e Shenjtë (Biri, ati dhe shpirti i shenjtë).

- Jezu Krishti u lut tri herë në Kopshtin e Gjetsemanit para se ta arrestonin.
- Jezu Krishti u var në kryq në orën e tretë (3) të ditës dhe vdiq në orën e nëntë (9) të ditës, sipas matjes së orës në kohën e Krishtit.
- Gjatë varjes së Krishtit në kryq, tri (3) orë errësirë e përfshinë vendin, aq sa zgjati edhe vuajtja e tij para vdekjes.
- Krishti qëndroi i vdekur për tri (3) ditë të plota dhe për tri (3) netë të plota.

Nëse studiojmë emrat Doruntina dhe Konstandin do të vijmë në përfundimin se:

- Emri **DORUNTINA** është hulumtuar nga studiuesit dhe sot përdoret shumë pasi anë e mbanë botës ku ka shqiptarë ka me mijëra vajza që quhen Doruntina. **Portreti i Doruntinës** ka diçka qiellore ose ajo është ëndërr. Ajo është si diçka që nuk i takon plotësisht as jetës as vdekjes; ose ajo nuk mund të shpjegohet me asgjë materiale të kësaj bote. Autori thekson ngjyrën e verdhë të flokëve dhe buzët e bukura... **Autori thekson detajet më seksuale të femrës:** flokët dhe buzët. Raporti që krijon me atmosferën e përgjithshme është ai i kontrastit. Atmosfera është e rëndë, tragjike dhe në mes saj gjendet Doruntina e bukur, e brishtë. Figurat stilistike të përdorura: **Krahasimi:** si mjegulla, si vesa e mëngjesit; epitetet: e ëmbël, e holluar, kaltëroshe; metaforat: e frenuar prej tij qetësisht, ajo mjegull kaltëroshe të dendësohej e të krijonte një re

Nëse e studiojmë emrin nga një pikpamje simbolike, duhet fillimisht të studiojmë momentin e takimit të Doruntinës me vëllain e saj Konstandinin. Gjatë këtij momenti Doruntina e kap për

dore Konstandinin dhe vëren se dora e tij ishte akull e ftohtë, madje edhe e pyet se përse e ka aq të ftohtë dorën. Nëse e ndajmë emrin e saj në pjesë të veçanta do të fitojmë:

(Dorë) – (Unë) – (Ti) – (Na/ ne, neve të dy)

- Ndërkaq nëse e ndajmë në pjesë të veçanta emrin **Konstandin** do të fitojmë:

(Ko) – (un) – (s'ta) – (ndin) që nënkupton “Kush t’a ndijë” – “Kush ta dëgjojë” dhe përkon me shprehjen “Kush do ta degjojë, s’do ta besojë”. Shprehje, e cila vlen edhe për historinë e ringjalljes së vëllait të vdekur nga varri për të mbajtur besën e dhënë.

Vetë Kadareja¹⁴, te *Ftesë në Studio*, shkruan: “Të gjitha pyetjet që janë bërë prej lexuesve (disa herë prej kritikëve) se kush e solli Doruntinën, nusen e martuar larg, që kërkon ta besojnë se e ka sjellë i vëllai i vdekur, më kanë torturuar së pari mua vetë. Si njeriu që lëviz në shtrat për të larguar gjumin e keq, kam arritur gjer më sot t’i shmang. Gjatë tundimeve të shkurtra për të gjetur një sjellës, personazhi që më është afruar si hije ishte Stresi vetë”. Se çfarë e shtyn Stresin ta bëjë një gjë të tillë? Përgjigjja duket të jetë e thjeshtë: dashuria që kishte pasur gjithmonë për të. Ai vetë pranon se: E kishte parë në ëndërr, por s’ishte i sigurt kur. Ndoshta tani vonë, disa net më parë. Ose një ëndërr e mëparshme i kishte ardhur përsëri. Kishte qenë gjysmë e shtrirë mbi një shilarës, pothuajse e zhveshur, dhe ai, ndonëse digjej nga dëshira nuk i avitej dot. Herë e pengonte shilarësi, herë vetë seksi i saj, që kushedi pse ishte zhvendosur nga e djathta, përbri trupit. Ravijëzimi i Doruntinës si diçka jo reale vlen së pari sepse legjitimon mitiken e personazhit të saj. E largët, lëvizëse si shilarëse ajo vjen në trajtë amorfe si te Stresi ashtu edhe te lexuesi. Seksi i spostuar është më shumë një trillim i mendjes së Stresit, një halucinacion seksist i frikës së tij për t’u përpirë nga natyra e gruas. Frika e pavetëdijshme përplasat me vetëdijen dhe thyhet te seksi i gruas së tij reale. Skena e dashurisë midis tij dhe gruas, është një moment penetrimi në disa trupa, fizikë dhe qiellorë. Ai depërtoi në seksin e saj me një rreshk të pazakonshëm ... e ndihte fundin e barkut sa mundej, ndërsa ai rrekej të shtyhej sa më thellë në të, si të kërkontenjë tjetër seks. Kishte ndjesinë se i përkiste një grimë, atje ku niste një natë dhe një lagështirë tjetër, pastaj, buzët e seksit tjetër tërhiqeshin më thellë, endillnin në një zonë të pamundur, në tejanë. Ai lëshoi një ah çnjerëzor, ... Doruntina vjen më tepër si ide sesa formë te Stresi; ajo është një dëshirë çdo burri për të pamundurën, e cila nuk faktohet asnjëherë, por

¹⁴ Irena Myzeqari *Ligjërimi feminist te kadare*, UETPRESS, Tiranë, korrik 2018 f.11

mbetet gjithmonë aty si forcë shtytëse. Këtë ravijëzim të femërores te Doruntina e balancon gruaja e tij, e cila si personazh i papërcaktuar mëkëmb dualizmin që ka femërorja në dy fazat e saj, kur është ide si Doruntina dhe kur faktohet si formë te gruaja.

Doruntina është zëri i të pamundurës. Është terri i huaj për Stresin, është motra dhe bija e martuar larg për nënën dhe vëllain. Ajo është përfaqësuese e të gjitha përpjekjeve që bën njeriu për të arritur atë çka dëshiron; të dashurin të niset për ta rikthyer dhe vëllain për t'u ngritur nga dheu dhe për t'i mbajtur besën. Besa është ajo, femra dhe gruaja, përpjekjet të cilat nuk shterojnë për të arritur dhe përmbushur secilën. Ajo është misteri, është dilema. Edhe pse shfaqet në roman vetëm në tri kapitujt e parë dhe më pas ndërron jetë bashkë me të ëmën, ajo i jep jetëtë gjithë veprimit të mëpasshëm që ndodh midis personazheve. Heshtja esaj është njëkohësisht për Stresin dhe për të; ajo kërkon me ngulm të ruajë reputacionin që nuk është larguar nga i shoqi me Stresin dhe prandaj shfrytëzon besën si legjitimuese të veprimit të saj. Kadareja e përdor sërish gruan si terrenin ku përplasen të gjitha betejat sociale dhe seksuale. Doruntina si e tillë është e para që martohet larg, që thyen barrierat e largësisë dhe vjen sërish në tokën e saj, pavarësisht me cilën kosto. Por ama Kadareja veprimin e saj e lidh gjithmonë me atë të burrit, pafigurën e të cilit çdo veprim i saj do të ishte i pamundur sociologjikisht dhe seksualisht. Një rol të veçantë në të gjithë veprën luan edhe kori, i cili si element mitik, vjen te ky roman në formën e vajtojcave, të cilat shfaqen ditën e vdekjes së Zonjës Mëmë dhe Doruntinës.

Ato janë aty për të përmbushur traditën veriore të vajtimin të të vdekurave, por fjalimi i tyre është me rëndësi për të gjithë ngjarjen. Ato, të veshura krejt në të zeza, me fytyra të përpira qysh më parë nga vajtimi i ardhshëm, kaluan mospërfillëse përpara tij. Stresi pati përshtypjense e njohën, sepse në sytë e tyre, iu duk se pa një dritëz talljeje ndaj tij, prishësit të gojëdhënës. Mendimi se kishte hyrë në dyluftim me vajtoret, iu duk se do t'i shkaktonte një të qeshur mu aty, përpara tyre, mirëpo për çudi nuk i la veçse ftohtësi. Gjuha e tyre emocionale vendoset përballë gjuhës faktike të ftohtë të Stresit, duke legjitimuar klishtë komunikative se gratë u afrohen më tepër të vërtetave subjektive, ndërsa burrat realiteteve objektive.

Të vishem si gjeraqinë,

Në ke ardhur për të keq,

Të vishem si kallogre,

Sillte vajtorja, fjalët e Doruntinës.

Eja, motër, sikundër je,

Të vendosura përballë Stresit, vajtojcet krijojnë përplasje forcash dheme këndet e tyre krijojnë një ligjërim krejt tjetër nga ç'është e vërteta, si përpjekje për t'u strehuar te mitikja, e vërteta e së cilës është më e përbalueshme sesa e vërteta reale e ngjarjes, për të cilën askush nuk di, por të gjithë hamendësojnë. Stresi është politikja, ndërsa ato mistikja, ai është syri perëndimor apolonian, ndërsa ato amazonat. Në të gjitha fjetdhe lidhjet që krijon Kadareja, te ky roman më shumë se kurrë ai thekson karakterin mistik femëror, femëroren dhe ktoniken që trondit themelete çdo kujt. Vdekja, besa, vajtojcet dhe vetë Doruntina vendosen përballë ftohtësisë së Stresit, i cili, edhe pse si mëkatar, përpiqet” *të fshehë gjurmët, nuk i shpëton dot ktonikes, e cila është ajo që e tërheq dhe e merr pas vetes*”.¹⁵

¹⁵ Irena Myzeqari *Ligjërimi feminist te kadare*, UETPRESS, Tiranë, korrik, 2018 f.12

III. NGJASHMËRI DHE DALLIME MES BALADËS SË RINGJALLJES SË LETËRSISË GOJORE ARBËRESHE DHE ROMANIT “KUSH E SOLLI DORUNTINËN”

Të gjitha këto përbëjnë një joshje evidente që mund të kthehet në rrezik për të shkelur në terrene që gjinden jashtë objektivit të studimit. Pikërisht vetëdija e kryqëzimit të tërë universit njerëzor në mitologji përcakton nevojën e vetëpërkufizimit duke iu përmbajtur qëndrimit që miti në epos të shihet si figurë artistike. “*Arti i është dashur mitologjisë edhe në pikëpamjen konfesionale. Miti në vetvete, për të qenë tërheqës si kult si produkt hyjnor kishte nevojë për veshje estetike*”.¹⁶

Të besosh që i vdekuri është ngritur nga varri do të ishte marrëzi, do të të thonin që ke luajtur mendsh. Megjithatë, misteri i këtij romani është aq i madh sa që të luhat mendimet deri në atë masë sa që të bën të çmendesh apo të largohesh nga të gjithë. Shtrohet pyetja pse..? I

25

vdekuri s'ngrihet nga varri. Ky është ligj i natyrës, ligj i Zotit...Por, vallë na lejon Kadareja t'i qëndrojmë besnik këtij mendimi, këtij besimi? Ka mëshirë vallë ai për lexuesin e tij? Që ska aspak mëshirë e kuptojmë fare lehtë sapo kuptojmë dy elemente: njëri, që Konstandini vdiq dhe elementi tjetër që bie në kundërshtim me të parin, është kur paraqitet një i huaj para Doruntinës dhe asaj i ngjason me të vëllain. Kjo pra të ndalon, të bën të marrësh frymë thellë, madje ta mallkosh autorin, kanunin, besën, të bërtasësh në kup të qiellit, ... vafshi në djall të gjithë siç jeni.

Legjenda për motrën me nëntë vëllezër është e njohur mirë ndër shumë popuj të Ballkanit. Kjo legjendë pasqyron ngjarjen në mënyrë mjaftë komplekse: ngrihet nga varri vëllai i vdekur, vete dhe ia sjell së ëmës të bijën, motrën e vet, që ishte martuar shumë larg, për ta realizuar në këtë mënyrë fjalën e dhënë. Ndërkaq, emrat e vëllezërve dhe të motrave ndryshojnë sipas varianteve dhe vendeve ku këndohen.

Elemente të legjendës: Emri i Doruntinës dhe Kostandinit; dy personazhet: Doruntina dhe nëna e saj; mallkimi i nënës; ngritja nga varri e Kostandinit; martesë larg e Doruntinës; vdekja e Kostandinit tre vjet më parë; udha e gjatë që Doruntina bëri; përfundimi tragjik i dy grave. Elemente të krijuar nga autori: personazhi i Stresit, ndihmësi, grua që ndihmon, hetimi që Stresi zhvillon, ndjenja e Stresit për Doruntinën, flokët e verdhë të Doruntinës, etj. **Tiparet:** shfrytëzimi i elementeve të legjendave, rrëfimi në vetën e tretë (rrëfyesi nuk është pjesëmarrës në ngjarje), modernizimi i karaktereve letrare në mënyrën e të menduarit e të të ndjerit, riaktivizimi i fjalëve të periudhës paraturke, krijimi i fjalëve të reja me brumin e shqipes, përzierja e ligjërimeve të brendshme me fjalët e autorit, etj. Te të dy gratë theksohen **sytë:** Zonja mëmë ndoshta kërkon shpjegim për atë që ka ndodhur. Ajo mendon se mallkimi i saj e ka ngritur të vdekurin nga varri. Kjo i krijon një gjendje tmerri. Ideja se e bija ka ardhur me një të vdekur. **Doruntina i ka sytë pa shprehje.** Lajmi se i vëllai s'është më e ka tronditur sa e ka lënë pa gojë. Të dy gratë janë të tronditura thellësisht nga të vërteta që pohohen me sy, por që ndoshta nuk do të zbulohen kurrë. Të dy gratë përpiqen të komunikojnë me anë të syve. Doruntinës i janë tharë lotët; ose ajo është në një botë tjetër. Është e shokuar nga trauma...

Kështu, fjala vjen: *“në variantet bullgare vëllai quhet Konstandin, Millan, Stojan, Llazar, etj., motra Peranka, Jana, Grozdana, Evdokija, etj. Te variantet greke vëllai Konstandin, motra Areti, Evdokia; kurse te variantet jugosllave : vëllai Kosta, Millovan; motra Evdokija, Elena e të tjera”*¹⁷.

¹⁷Demush Shala, *Letërsia popullore*, f. 189.

Folklori është burim i pashtershëm prej të cilit kanë dalë personazh të shumtë. Pjellë e këtij folklori janë edhe personazhet baladës së njohur “Motra me nëntë vëllezër” që sot e njohim më gjerësisht falë romanit të Kadaresë “Kush e solli Doruntinën” Pra, baladën Kadare e përdori si farë, me të cilën më pas gatoi romanin e tij të mrekullueshëm.

Në shikim të parë, subjekti i kësaj balade duket shumë i thjeshtë, por sa më shumë ta lexosh aq më shumë ndërlikohet, sepse çdo rilexim zbulon një fshehtësi, nxjerr në pah një pikëpyetje apo pikëçuditëse. Siç thamë edhe më lartë, subjekti duket i thjeshtë. Nis me një përshkrim të zakonshëm të familjes

*“Ish një mëm shumë e mirë,
kisht nëntë djem të hijshëm,
e të dhjetën kish një vajzë,
që e quanin Garenitë”¹⁸*

Më pas shohim të diskutohet rreth fejesës dhe martesës të së motrës në vend të largët, nëntë konaqe larg vendlindjes. Pakënaqësi lidhur me këtë martesë shfaq e ëma dhe disa nga vëllezërit, e mos flasim për Doruntinën të cilës si pëlqente aspak, por që s’kishte ç’të bënte, e kishte patjetër, pasi për fatin e saj vendosnin të tjerët. Këtë e dëshmojnë vargjet:

*“Pa m’nigjoni vllaznit e mi,
sall ni motë tjetër spat,
si u kujtuet n’Krajli mem tret?*

Citatin 14 N’vent rrogtarit bukën me ma qitë,

Citati 15

e pat kollaj me m’majtë” ... Halil garia

ose

“Ore vllazën medet! Ju ka thanë

¹⁸Demush Shala, *Letërsia popullore*, Rilindja, Prishtinë, 2002, f. 189.

pse kët nom ju me ma bo,
non kopila me jav pas bo,
mu kaq larg s'osht desht me më dhonë,
une juve shka u kam bo,
*non konaqe larg me më dhon" motra ne nond vëllezër*¹⁹

Të jesh motër e nëntë vëllezërve, të jesh bijë e një fisi të madh, të jetosh në kohën e kanunit, do të thotë të mbyllësh gojën dhe të përtypësh gjithçka që të jepet, sepse vetëm në këtë mënyrë ruhet botëkuptimi i vjetër patriarkal.

Përkundër gjithë sjelljeve, motra zakonisht nuk mbante mëri me vëllezërit e saj. Nuk u kthen fjalën atyre dhe ka besim kur ato i premtojnë diçka . Tragjedia familjare fillon me vrasjen e nëntë vëllezërve në luftë:

"Erdh një vit shumë i prapë,
e i korri asaj zonje,
*nëntë bijtë në një shesh lufte"*²⁰

Kështu, në **variantën arbëreshe** vëllezërit e Garenitës vriten në një luftë, gjë që nuk ndodh variantet e tjera këndeje Adriatikut. Kjo, edhe e bën atë më interesante, madje njërën ndër më të bukurat të këtij lloji. Pra, vdekjen e vëllezërve në motërzime e shkaktojnë fenomene të llojllojshme, si bie fjala:

"Me vrapa dolla në avlli,
të marrë një kërcu të zi,
Të më `piket një stehi,
me vrap m u hoth në kusi,
*më helmoi djemt e mi,"*²¹

¹⁹Po aty, 189

²⁰Po aty, 191

Kështu, ndonjëherë ata i helmon gjarpri, ndonjëherë mortaja, si bie fjala “*te Aliu dhe Fata, Halil Garia, madje në disa sosh, si te “Motra me nëndë vëllezër”, verbohët edhe e ëma e tyre, gjë që e bën atmosferën edhe më të rëndë. Është interesant edhe fenomeni se, në të gjitha motërzimet e ëma e djemve, shpëton, qoftë nga lufta, nga helmimi i gjarprit apo nga mortaja*”.²²

Është ky një problem delikat që padyshim ka edhe një arsye qenësore, e cila e zhvillon ngjarjen pasi vetë Zonja Mëmë duhet t’ia kujtojë Konstandinit të vdekur, fjalën e dhënë. Andaj, ajo një ditë kremteje, kur u ndez nga një qiri të bijve të saj, Konstandinit i ndez dy qirinj dhe fillon të vajtojë mbi varrin e tij. Vargjet në vazhdim flasin për këtë.

*“Konstndin o biri im,
ku ë besa që më dhe,
se do më sillje Garenitën,
Garenitën tët motër?
Besa jote nën dhe.”*²³

Lidhur me këtë legjendë ekzistojnë motërzime të shumta. Në njërën nga to, në vend të Zonjës Mëmë, bisedën me Konstandinin e bën zogu i malit, të cilin e dërgon vetë Garanita, e cila kërkon llogari për besën e dhënë, sepse besa ishte një ndër virtytet më të çmuara të shqiptarëve, virtyt ky që sipas botëkuptimeve popullore është një virtyt që ngre të vdekurit nga varri. Përkatësisht ky ishte një nga virtytet me të cilin njiheshin shqiptarët në botë. Kështu, në motërzimet tona Konstandini, Halil Garria dhe Sokol Hyseini, janë ato që ngrihen nga varri në kushte të ndryshme për të çuar në vend besën e dhënë.

Duke qenë se motërzimet janë të shumta, edhe takimet e vëllëzërve me motrat e tyre bëhen në variante të ndryshme. Disa takojnë që në fillim vetëm motrën në oborr të shtëpisë, në ndonjë motërzim shohim të takojnë fëmijët e motrës duke lozur etj. Motërzimet tregojnë dallime edhe për ndjenjat e para që ka motra ndaj vëllaut në momentin që shihen. Në ndonjë motërzim motra sapo e sheh vëllanë i hidhet në përqaqim, kurse në ndonjë tjetër ajo ndonëse e

²¹ Po aty

²² Demush Shala, Letërsia popullore, Rilindja, Prishtinë, 2002, f. 191

²³ Po aty

përmalluar shfaq njëfarë droje: E i tillë është motërzimi me motrën e Halil Garrisë:

“Qyqja, vlla, me ty qysh vi?

Se ktu burri s’më ka qillue

asht nalt n’bjeshk, ka dalë me gjue,

kur t’vi burri, ktu mos më gjejë

i thonë shoqet- Nusja t’ka ikë

*erzi em ma gja nuk vie.”*²⁴

Bisedat mes motrës dhe vëllait zhvillohen në variante të ndryshme. Disa fillojnë me pyetje që i drejton motra vëllait ngase ka njëfarë drojtje, kurse në raste tjera shohim të shfaqur dashurinë dhe mallin që shpërthen mes tyre sapo takohen. Megjithatë, është fakt që vepra është e stërmbushur me dyshime dhe me pyetje, të cilat mbase dhe s’kanë përgjigje. Në disa nga motërzimet personazh me rëndësi janë edhe zogjtë e malit, të cilët ndjekin situatën dhe habiten me të vdekurin, i cili ec me vajzën e gjallë. E përbashkëta për të gjithë është se në të gjitha variantet mbyllja përfundon tragjikisht me vdekjen e Doruntinës dhe Zonjës Mëmë. Në disa raste hasim motrën të shndërruar në qyqe.

Motra me nëntë vëllezër është baladë mjaftë e njohur që këndohet ndër shumë popuj. Më të plotë e kemi në Kosovë. Këtu personazhe kryesore është Dylbere Fatimja, e cila nxit biseda të njerëzve për shkak se ishte shumë e bukur.

“Der këtë çikë Zoti qi e ka falë

Kjo kopila mutllak ka bo:

*se kaq larg nuk o desht me dhanë”*²⁵

Mendohet që balada është një këngë që ka të bëjë me ritet e martesës. Populli ynë e këndon këtë baladë më shumë gjatë festave, apo në dasma. Është fakt i pamohueshëm që “*legjenda e Konstandinit dhe Doruntinës shfaqet në forma të ndryshme në Ballkan. Një version popullor grek, “Kënga e Vëllait të vdekur” përqëndrohet në shpëtimin e motrës së Konstandinit, Areti (virtyti). Disa versione të tjera gjenden tek serbët dhe arbëreshët, shqiptarët që jetojnë në*

²⁴Demush Shala, Letërsia popullore, Rilindja, Prishtinë, 2002, f.189

²⁵Po aty, 195

Italinë e Jugut, të cilët e kanë origjinën në kohën e Skënderbeut. Sipas Robert Elsie, kjo legjendë është e njohur kudo ku banojnë shqiptarë”²⁶

3.1 SEMANTIKA E BESËS, FJALËS SË DHËNË E TË MBAJTUR

Fjala *besë* nuk lidhej etimologjikisht me fjalën bind, bindje, sikurse mendonte Gustav Meyeri (pra jo me foljen binden të gjermanishtes, që do të thotë lidh) por me fjalët greke: pitho, pistome dhe latine për besimin. Një veçanti tjetër e besës është që ajo hyri në Kanunin tonë të maleve si një i veçantë. Përkufizimi i kuptimit të parë të besës sipas fjalorit të 1954-s thotë: "afat sigurimi që i jepte shtëpia e të vrarit dorasit, e meshkujve të familjes së tij, me zotim që brenda kësaj kohe nuk kërkonte gjak prej tyre".

Ky, pra është kuptimi kryesor i besës dhe me këtë veçanti ajo hyri në disa gjuhë ballkanike, kështu deri dhe në turqishten ku do të thotë "armëpushim midis dy individësh ose palësh".

Në përdorimin jashtëkanunor besa hyri si një sinonim përforcues për "fjalë e dhënë". Vetë karakteristika e saj dyfishe, pra që kishte brenda edhe betimin edhe besimin, e krijonte natyrshëm këtë përforcim: pra, jap fjalën duke bërë be mbi të (plus brenda ngjyrimi që besoj në këtë betim).

Me sa duket këtu luajtën rol dy faktorë që e nxirrnin të dobët "fjalën, fjalën e dhënë". Në shqipe fjala "fjalë" është disi e lehtë, fjalë njeriu thotë shumë, "fjalët i merr era", "fjalën e mirë e gurin në trastë", shkurt, një fjaleë të thjeshtë nuk i zihej besë.

Rastet e shumta të pabesisë, thikat pas shpine, ndërrimet e shpeshta të kampeve, të besimit, bindja ndaj më të fortit, i shtynë mesa duket shqiptarët të kërkonin njëfarë rituali për t'i besuar fjalës së dhënë dhe ky ishte betimi mbi këtë fjalë, d.m.th. besa.

Në gjuhë të tjera ky përforcim nuk ekziston sepse mesa duket ka qenë i panevojshëm, kështu anglezi thotë "to give his word", gjermani "sein Wort geben", italiani "dare la parola" e kështu me radhë dhe kjo u mjafton.

Gjithë harlisjet e kohëve moderne për besën si një institucion besnikërie karakteristik për shqiptarët, për shqiptarët si njerëz që japin edhe jetën për të mbajtur fjalën, janë thjesht krijime të fantazisë dhe nacionalizma.

²⁶ Peter Morgan Kadare, Shkrimtari dhe Diktatura 1957-1990, f.186.

Këtë na e vërtetojnë edhe shprehje boshe si "shqiptari kur jep fjalën ther djalit", d.m.th. natyrisht që nuk e bën por vetëm e thotë, e po kështu ndodh me besën në dramën "Besa" të Sami Frashërit.

Ndryshon puna me besën kanunore, fjala e dhënë që për një kohë të caktuar nuk ka me u derdhë gjak, kjo po është e rëndësishme se ka të bëjë me kokë njeriu, ky mund të quhet institucion i veçantë për malet e Shqipërisë. Por jo një institucion nga ato me të cilët mund të mburremi faqe botës.

Kurse me besën poetike vazhdojmë të mburremi, për shembull që kaq e fortë është kjo fjalë, saqë ajo e bën të vdekurin të ngrihet nga varri vetëm e vetëm që ta mbajë besën, sikurse ndodhi në rastin e Konstantin gjëmëmadhut që u ngrit nga balta për ta sjellë në shtëpi Doruntinën.

Krijohet përshtypja sikur vetëm shqiptarët e kanë këtë baladë, sepse vetëm ata e kanë besën. Në të vërtetë motivi i ngritjes së vëllait ose burrit nga varri është i përhapur në të gjithë popujt e ballkanit dhe më tej.

Ndryshojnë vetëm nuanca, kështu p.sh. në variantin serb motiv kryesor është dashuria e motrës, kurse në variantet shqiptare, greke e bullgare është dashuria e nënës ajo që e bën vëllanë e vdekur të ngrihet nga varri.

Motivi i kalorësit të vdekur është p.sh. shumë i njohur edhe në Gjermani si Balada e Lenorës, falë poetit Gottfried August Buerger, autorit të "Baronit Mynhausen" dikur shumë popullor edhe te ne. Kudo, në gjithë vendet ballkanike e evropiane ku është endur motivi, ndoshta edhe më tej, thelbi është që duhet çuar në vend fjala e dhënë. Tjerrja false e fjalës së dhënë si veçori e shqiptarëve përcaktoi edhe shfaqjen e ditës së shtunë në Teatrin Kombëtar, me titull "Doruntina" nga një trupë e përzier aktorësh kosovarë e amerikanë.

Megjithë përpjekjen dhe lojën e pakursyer të aktorëve, përmbajtja e stërnjohur dhe boshe e subjektit që përmbledhet në fjalinë "*Konstandini i dha besën nënës se do t'ia sjellë gjithqysh vajzën e martuar larg dhe e bëri këtë gjë edhe i vdekur*" solli që gjithë kohën të ripërtypej ky pohim.

Ai u kthye në të gjithë kullotumbat dhe kuajt e mundshëm, në shqip dhe në anglisht, me nga dy-tre Konstantinë dhe dy-tri Doruntina, ai ngriti në këmbë gjithë kabatë e Jugut të Shqipërisë dhe kur pa që s'mjaftonin futi brenda një kërcim pule-disko dhe aerobi amerikane.

Krejt veprimet rreth fjalës së dhënë, kulmuan në fund te pohimet që "besa është feja e shqiptarëve" dhe, pasi që dy gratë - nënë e bijë - mbyllën sytë, bota do të dëgjonte për këtë vend ashtu siç kishte dashur Doruntina të ndodhte.

Ndodh shpesh që në hapjen e dritares të synojmë hedhjen tutje të një ligji jetik e të vyeshëm për të kaluarën, por në pikëpyetje për të tashmen dhe ditën e nesërme, në të cilën qenia jonë kërkon arsyen e jetesës. Ndodh që mendojmë nëse duhet ta trashëgojmë atë ligj, apo ta lëmë në mëshirë të kohës dhe erës, të cilat rrëmbimthi do ta marrin për të mos e lejuar si pjesë tonën, për t'ia marrë të drejtën e frymës dhe fjalës.

Bota u ndërtua me ligje, dhe si e tillë arriti të jetë vend, ku qenie të ndryshme lënë gjurmë dhe shenja mbi të, sepse siç dimë nga fjala e shkrimtarit: "*Në jetë gjithçka është shenjë.*"²⁷ Shenja paraqesin edhe ligjet që populli ynë i ndërtoi dhe kërkoi që tjerët t'i realizojnë dhe t'u prehen në paqe. Një ligj të tillë populli shqiptar e ka në gjak. Flenë, zgjohej, jeton, dashuron dhe vepron me të, në përditshmëri, duke e bërë pjesë të pandashme edhe kur del dielli, edhe kur del hëna e yjet i bëjnë shoqëri, edhe atëherë kur qielli me vranësi mposht dëshirën dhe mbyll njeriun me ëndrra. Në çdo gjë e për gjithnjë.

Është dëshmuar disa herë ajo që është e trashëguar nga populli shqiptar. Është bërë imazh yni në çdo njohje të re, në çdo gjë të thënë më parë, në shumë, pavarësisht se dimë që: "*Imazhi ynë është një dukje e thjeshtë, mbrapa së cilës fshihet substanca e vërtetë e unit tonë, e pavarur prej vështrimit të botës.*"²⁸

Shumë këngë dhe lahuta kanë shoqëruar atë ligj, shumë poezi kanë qenë me një motiv të tillë, shumë romane ngërthejnë atë temë, shumë ese marrin elemente të saj, shumë gjëra rreth një gjëje- rreth "*besës shqiptare*". Kundra thekson se: "*Emri është shenjë e shpirtit*",²⁹ ndërsa për ne, shenjë shpirti ishte fjala e dhënë. Nuk janë të paktë as të huajt që e njohin këtë ligj tonin, duke e parë atë në veprimet dhe përditshmërinë e personazheve që pena e shkrimtarit shqiptar e sjell atë edhe për të huajt, për ta rrëfyer vlerën e qenies sonë dhe frymën me të cilën rritja jonë u shoqërua me shekujt në vazhdimësi.

²⁷Paulo Coelho, *Alkimisti*, Botimet TOENA, Tiranë, 2004, f. 92.

²⁸Milan Kundera, *Pavdekësia*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, f. 145.

²⁹Milan Kundera, *Lehtësia e papërballueshme e qenies*, Albin, Tiranë, 1997, f. 287.

Është ligji i *besës* që na njohu me të tjerët, duke na zbuluar para tyre shpirtin dhe frymën tonë, sepse siç thotë edhe Hygo:”*E vërtetë ose e rremë qoftë, ajo që thuhet për njerëzit, zë po aq vend në jetën e tyre e sidomos në fatin e tyre sa edhe punët që bëjnë.*”³⁰

Rrëfimet e ndryshme na njohin me një botë ku ne japim më të mirën tonën, vetëm për të qenë ato që na ka mësuar koha dhe jetikja në qenien tonë, sepse ndryshimi harron të djeshmen, e ne atë nuk e lejuam të jetë sundues. Njohin aty gjënë që ne e trashëgojmë mahnitshëm për sytë e tjerë, vetëm pse nuk guxojmë të thyejmë vlerën dhe të mposhtim kalanë e ndërtuar me shekuj, pavarësisht se kemi dëgjuar që: “*Çdo gjë që është e mirë lind nga gërmadhat e së vjetrës, nga e keqja, nga qëndresa, nga mëkati kundrejt së vjetrës dhe institucioneve të saj të shenjtë.*”³¹

Bëmë atë që koha ka qenë e detyruar të na vendos si rregull kryesore për ta vazhduar jetën me synimet tona, sepse jemi ruajtur, dhe para botës ka qenë ajo që na ka treguar krenarë, të pamposhtur, të pathyer e të besueshëm. Ka qenë ajo që ne jemi këtu edhe sot.

Në fillim ishte fjala, thonë njerëz të ndryshëm, bazuar në libër të shenjtë. Por, për ne në fillim ishte “*besa*”, që kur njohim ekzistencën e një populli të këtillë. E mbajtmë atë, e bëmë pjesë të pandashme, e rritëm në qenien tonë, në thellësi të shpirtit ia lëshuam vendin më të mirë, e pagëzuam edhe tjetrën me të, vetëdijshëm dhe me arsye njerëzore, padashur ia dhamë një ligj dhe kërkua që tjetra ta njeh dhe ta bëjë motërzimin me të. Sepse ashtu do të ishte jona. Me t’u munduam ta ruajmë jetën tonë njerëzore, pavarësisht gjërave tjera të njëkohshme, sepse siç është thënë më parë: “*Ndjenja e ruajtjes së jetës është kaq e lejueshme, saqë njeriu ndonjëherë është shtyrë të vrasë edhe njerëz të pafajshëm.*”³²

Në veprën letrare të Kadaresë e kaluara zë vendin kryesor, duke e bërë atë me frymë të aktuale, dhe duke e sjell pranë lexuesit me një formë të tillë letrare që njëkohësisht bëhet tërheqëse për ta njohur edhe të kaluarën, në pamundësi përjetimi. Në botën e artit letrar Kadareja jep një larmi temash, motivesh dhe elementesh, me ç’rast tregon pasurinë e popullit tonë, në marrëdhënie me elementin e huaj, por të ngërthyer në një jetesë të përbashkët tonën.

³⁰Viktor Hygo, , Të mjerët I, Rilindja, Prishtinë1985, f. 7.

³¹Johan Eolfgang Gete, Fausti, Rilindja, Prishtinë,f. 1964, f. 22.

³²Xhouvani Bokaçio, , Dekameron I, Tiranë, 1993 f. 18.

Ai jep shembuj të ndryshëm të një jete ku e kaluara ngërthen në vete çdo person, duke e detyruar atë të mishërohet me të djeshmen dhe me imagjinatën e së sotmes. Pavarësisht se kohët e fundi lexuesi e njeh Kadarenë veç me lëvrimin e prozës, duhet cekur se ai një synim të tillë në të dikurshmen shprehu edhe me lëvrimin e poezisë, sepse edhe Hygo thekson që: *“Poezia e një populli është element i përparimit të tij, bazë e admirueshme. Niveli i qytetërimit matet me sasinë e imagjinatës. Veçse një popull qytetërues, duhet të qëndrojë një popull burrnor.”*³³

Ajo çka zë vend të rëndësishëm për lexuesin e romanit që vështrohet në këtë punim, është përqendrimi në ringjalljen e njeriut për të mbajtur besën dhënë së ëmës. Është një element që na bën të besueshme vlerën e amanetit dhe peshën e tij për popullin tonë, duke parë që edhe balada arbëreshe edhe romani i Kadaresë japin një ringjallje vetëm për të përmbushur atë amanet. Se si jepen këto dy forma dhe çfarë kanë të përbashkët e dallime balada me romanin, po e japim në këtë ndarje të mëposhtme:

BALADA	ROMANI
1. Balada fillon me këto vargje: <i>Gjashtë e gjashtë dymbëdhjetë</i> <i>Doruntina trembëdhjetë</i>³⁴.	1. Romani fillon me këto fjalë (koha e ardhjes): <i>Stresi ishte ende në shtrat, kur iu duk se dëgjoi</i> <i>një trokitje te porta: tang-tang-tang.</i>³⁵
2. Nëna me dymbëdhjetë djem dhe një vajzë;	2. Nëna me nëntë djem dhe një vajzë;
3. Jepen vetëm emrat e personazheve;	3. Jepet dhe mbiemri i tyre- Vranaj;
4. Nëna dhe njëmbëdhjetë djemtë nuk pajtohen me martesën e largët të Doruntinës ;	4. Nëna dhe njëmbëdhjetë djemtë nuk pajtohen me martesën e largët të Doruntinës;
5. Pajtohet vetëm Kostandini;	5. Pajtohet vetëm Konstandin;
6. Dasma zgjati 9 ditë, ditën e 10 shkon nuse;	6. Nuk jepet kohëzgjatja e dasmës;

³³Viktor Hygo,, Të mjerët III, Rilindja, Prishtinë, 1985 f. 340.

³⁴Mitrush Kuteli,,Tregime të moçme shqiptare,Çabej&Feniks,Tetovë, 2003f. 20.

³⁵ Ismail Kadare,,Kush e solli Doruntinën, Flaka e vëllazërimit, Shkup1997,f. 11.

7. Luftërat morën gjithë djemtë e nënës; 8. Nëna e Doruntinës thirret –Zonja mëmë; 9. Nuk jepet vendi i saktë i martesës së D.; 10. Nuk jepet mosha e Doruntinës; 11. Nuk jepet koha e ngjarjes; 12. Nuk jepet vendi i veprimit; 13. Nëna viziton varret të shtunën; 14. Mbi çdo varr ndez nga një qiri dhe bën nga një vajtim; mbi varrin e Kostandinit ndez dy qirinj e bën dy vajtime; 15. Nuk jepet sa zgjat udhëtimi i Doruntinës; 16. Nuk jepet koha e nisjes së udhëtimit; 17. Kalorësi u pa nga vajzat në valle; 18. Koha e ngritjes nga varri- mesnatë; 19. Nuk ka hetues të ngjarjes; 20. Udhëtim i një të vdekuri me një të gjallë; 21. Fjalët e nënës mbi varrin e Kostandinit: <i>Kostandin, o biri im, ku është besa që më dhe, se do të ma sillje Doruntinën, tët motër? Besa jote vdiq bashkë me ty e kalbet në varr të zi.</i>³⁶	7. Luftërat morën gjithë djemtë e Zonjës mëmë; 8. Nëna e Doruntinës thirret- Zonja mëmë; 9. Jepet vendi i martesës- Viset e Bohemisë; 10. Jepet mosha e saj- 23 vjeçare; 11. Jepet koha- në stinën e vjeshtës, 11 tetor; 12. Jepet vendi i ngjarjes- Arbëri, natë; 13. Nëna viziton varret e djemve të dielën; 14. Mbi çdo varr ndez nga një qiri, ndërsa mbi varrin e Kostandinit ndez dy qirinj; 15. Jepet zgjatja e kohës së udhëtimit- 13 ditë; 16. Jepet koha e nisjes- 29 shtator; 17. Kalorësi u pa nga gratë e fshatit; 18. Nuk jepet koha e ngritjes nga varri; 19. Ka hetues të ngjarjes- Stresi me ndihmësin; 20. Udhëtim i një të vdekuri me një të gjallë; 21. Mallkimi i nënës është ky: <i>Kostandin, ku e ke fjalën që më dhe se do të ma sjellësh Doruntinën sa herë të kem nevojë për të? Tani që mbeta qyqe mbi dhë dhe pranë s'kam</i>
--	--

³⁶Mitrush Kuteli Tregime të moçme shqiptare, Çabej & Feniks, Tetovë, 2003f. 21.

	<i>askënd, ty që e trete besën, dheu mos të trettë.</i> ³⁷
22. Kalorësi ishte me pluhur;	22. Kalorësi ishte me pluhur;
23. Në baladë nuk flitet për incestin;	23. Në roman flitet për mundësinë e incestit;
24. Guri i varrit shndërrohet në kalë;	24. Guri(<i>simbol i tokës</i>) shndërrohet në kalë;
25. Nuk jepet koha e ardhjes;	25. Doruntina kthehet pas tre vjetësh tek e ëma;
26. Vdesin edhe nëna me të bijën.	26. Edhe në roman vdesin të dyja.

3.2 NDËRTHURJA E SUBJEKTIT TË KËTIJ ROMANI

Romani me karakteristika enigmatike “*Kush e solli Doruntinën*” ndërtohet mbi vlerën dhe peshën e fjalës “**besë**”, e cila, në vete dhe me veten, me tërë fuqinë dhe pa mposhtjen e saj ngrihet në pedestalin e së pamundurës, duke e krahasuar veten me fuqinë dhe vlerën e gjërave të shenjta ungjillore, siç thekson edhe studiuesi, Shaban Sinani.

Thelbi i romanit zhvillohet me përmbajtjen e njëjtë siç kemi pasur rastin ta njohim nga përmbajtja e baladës gojore arbëreshe, pavarësisht se në krahina dhe vende të ndryshme ndryshojnë disa elemente të baladës së ringjalljes, apo të ngritjes së njeriut nga varri për të përmbushur një akt të parealizuar më parë, dhe atë e japin në variante të ndryshme.

Romani në fjalë me anë të së shkuarës dhe ligjeve që për shqiptarët ishin pjesë e përditshmërisë dhe jetës, rrëfen të tashmen të mishëruar me shtresë mitologjike në shtatë krerët e tij. U theksua edhe më lart, që thelbi i romanit bazohet në *baladën e Kostandinit*, por që përshkohet nga një tis i hollë i misterit në rrjedhën e rrëfimit. Është ky tis ai që e bën romanin më tërheqës dhe më enigmatik për lexuesit e magjepsur pas mitologjisë dhe legjendave, të cilët paraprakisht duhet të kenë dëgjuar për baladën, që në këtë rast shërben si bazë dhe frymëzim krijimi.

³⁷Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1997, f. 53.

Tipologjia e romanit është roman enigmë. Enigma e romanit vërehet që në titull, por pavarësisht pyetjeve që bëheshin nga kapiten Stresi dhe njerëzit tjerë të Arbrit, askush nuk hidhte dritë mbi këtë enigmë jetike. Kjo enigmë bëhet më e plotë me vdekjen e Zonjës mëmë, zemra e së cilës bashkë me fjalën dhe sytë po tretej në dhé, pa zgjidhur çështjen shqetësuese për çdokënd. Ajo mori të fshehtë në varr, por sikur të ishte gjallë a do të mund të fliste dhe të zgjidhte atë që Doruntina solli me ardhjen e saj? Do të mundej zemra e një nëne të hidhte dritë mbi çështjen që zemra e saj e vuante që nga vdekja e djemve?

Në qendër kemi një personazh që ringjallet, ndërsa romani tregon njëherazi edhe bashkëjetesën e kulteve, si: atë të besës, jetës, vdekjes, ringjalljes, dashurisë dhe vatrës. Shumë kulte në një prozë me elemente enigmatike, për të treguar larminë dhe frymëzimin për njëra-tjetrën në këtë roman.

Romani i Kadaresë siç thekson edhe Sh.Sinani: *“Përshkohet nga një frymë e dukshme ungjillore jo vetëm në anën sipërfaqësore, në galerinë e personazheve, në mendësinë e tyre, por edhe në nocione thelbësore, si jeta, vdekja, ngjallja, ringjallja.”*³⁸

Gjatë ndërtimit të romanit, Kadareja lë hapësirë që lexuesi të jetë i qetë dhe pa frikë kur të parashtron pyetjen nëse është fjala **“besë”**, ajo që tregon trashëgiminë tonë etnokulturore dhe se pavarësisht gjërave dhe rrethanave, njeriu ka qenë i detyruar ta mbajë atë, ta përmbush e ta kryejë aktin, të cilit i është dhënë me shpirt kur e ka dhënë një premtim të tillë. A ka qenë fjala e dhënë ajo që gjithmonë ka qenë në gjakun e shqiptarit dhe a e ka udhëhequr ajo atë drejt realizimit të detyrave që ka marrë përsipër për realizimin e së cilave ka ndihmuar koha si faktor.

Por sot lind pyetja:- A ka qenë i vetëdijshëm Kostandini për premtimin që ka bërë ndaj së ëmës dhe a i ka menduar gjërat që do të vinin pas martesës së motrës larg nëntë male? Duke shprehur këtë mendim dhe pyetje, më vjen në mend ajo që tha edhe J. Green në romanin e tij, se: *“Ndonjëherë njerëzit nuk i kuptojnë premtimet që dhurojnë në çastin që i bëjnë.”*³⁹

Doruntina erdhi. Trokiti në portën e së ëmës dhe u vu në vend besa e dhënë. E ëma sërish dëgjoi zërin dhe frymën e saj. Çdokush duhet të ishte i kënaqur me këtë kthim dhe ta

³⁸Shaban Sinani Për prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë, , 2009, f. 106.

³⁹John Green Faji në yjet tanë, UEGEN, Tiranë, , 2014, f. 68.

pranonin Doruntinën ashtu si ishte në të vërtetë, të përmalluar, të gëzuar për kthimin, fjalëpak të, heshtur, të zbehtë, të lodhur nga rruga, me sy të gëzuar që do të shihte të afërmit e vet, pa ditur që në shtëpinë ku ishte rritur ishte shuar edhe simboli i trashëgimi së familjare, vëllezërit.

Por askush nuk u mor me këtë kthim, bile as edhe e ëma e saj, e cila në pyetjen se kush e solli Doruntinën, mori përgjigjen që asnjëherë s'do ta kishte bërë edhe armiku. Ajo nuk pranoi lehtë kalimin e vdekjes dhe varrit për të përmbushur premtimin e dhënë. Ajo e kishte të pamundur të pranonte edhe bindjen e Kostandinit kundër kishës dhe rregullave kishtare. Ajo kishte frikë të pranonte një botëkuptim ndryshe të të birit, në kohën kur kisha ishte mbi të gjitha.

Pavarësisht se Doruntina erdhi, askush nuk e gëzoi këtë ardhje. Gjithkush e pa si diçka të keqe nëse mund të thuhet kështu për këtë fakt, dhe filluan të largonin tisin e hollë që mbulonte dhe zinte sipërfaqen e enigmës për kthimit e Doruntinës, sepse vetë Kadareja thekson që: *“Njerëzit kur nuk duan të veprojnë kundër një të keqeje, jepen pas kërimit të shkaqeve që e sollën atë.”*⁴⁰

“ Ringjallja e Kostandinit u bë edhe përkundër mendimeve që mbronte kisha dhe kundër atyre që nuk besonin në një ringjallje të dytë, pas asaj të Krishtit. U realizua premtimi dhe Doruntina erdhi pranë së ëmës, kur kjo e fundit me mall priste kthimin e së bijës, kur kishte krijuar një lidhje simbiotike me natyrën. Vlen të përmendet mendimi që ringjallja e Kostandinit dëshmon se fuqia e njeriut është e barabartë me atë të hyjnive.”⁴¹

Pas çdo mendimi apo paragjykimi që mund t'i bëhet kësaj vepre me elemente enigmatike nga çdo anë, duhet të pranojmë mendimin e Sh. Sinanit, që: *“Autori u shprehet lexuesit se nderimi për besën e dhënë është nderim për ringjalljen dhe se një vlerë juridike etike e tillë nuk do të kishte atë shkëlqim pa frymën evangjelike, ungjillore.”*⁴²

⁴⁰Ismail KadareUra me tri harqe, Album, Tiranë, 2000, f. 49.

⁴¹Arlind Farizi, Tipologjia e personazheve në romanet e Ismail Kadaresë, Tringa desing, Tetovë, 2015, f. 135.

⁴²Shaban SinaniPër prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë, , 2009, f. 112.

3.3. KUSH E SOLLI DORUNTINËN?!

Ajo erdhi. Këtë e pranuan të gjithë. Në mesnatë hëna dhe yjet panë sërish bukurinë e saj. Kalorësi ndjeu nga afër frymën e Doruntinës dhe hijeshinë e vjedhur nga një zanë. Kalorësi bashkë me trokëllimën e kalit, ndjente edhe frikën e Doruntinës sa më shumë që i afrohej shtëpisë atërore. Po përse një frikë e tillë? A nuk ishte shpirti i saj ai që marrëzisht donte kthimin dhe përjetimin e sërishëm të dashurisë pranë familjes së saj? A nuk ishte ajo që në Bohemi kishte ndjerë lëndimthi mallin më të madh për të ëmën, e cila ishte kundër martesës së saj në vendin e largët, bashkë me njëmbëdhjetë vëllezërit e tjerë? Përse duhej të ndjente frikë se ç'përgjigje do të jepte për sjellësin e saj, që për vetë atë ishte një shpëtimtar? A nuk duhej të ishte më e qetë kur ta pohonte se ka udhëtuar me një të vdekur? A nuk duhej që sytë e saj ta thoshin të vërtetën dhe të mos e shtonin ende misterin e ardhjes së saj???

Këto pyetje bëhen në çdo lexim të rreshtit të ri të romanit, sepse vetë ai na lejon një gjë të tillë, por nuk na jep një zgjidhje të dëshiruar me kohë nga të gjithë. E pranojmë që fjala e dhënë u mbajt. Jemi një edhe me Kadarenë, i cili trajtoi në roman një temë të tillë. Por përse duhej të ishte ringjallja e sërishme në këtë botë ajo që do ta ngatërronte edhe më këtë enigmë. A nuk ka qenë vetë Krishti ai që është ringjallur sërish për të realizuar një detyrë të papërmbushur më parë? Përse duhej ta bënte edhe Kostandini një hap të tillë dhe të dilte para së motrës jo ashtu siç ajo në të vërtetë ta njihte? A nuk duhej që ta fshinte pluhurin dhe të bëhej më i arsyeshëm para saj? A nuk duhej që ta përqafonte me mall, për ta shlyer mallin tre vjetor të largimit të së motrës nuse? A nuk duhej t'ia tregonte asaj të vërtetën, në mënyrë që ajo të ishte e përgatitur para së ëmës? A ka faj Kostandini për këtë fshehje???

Për çdo roman Kadareja jep një zgjidhje në fund pavarësisht natyrës së saj, të mirë apo të keqe, lumturuese apo trishtuese. Po për këtë roman a nuk ka ndjerë një përgjegjësi të tillë? A nuk do të ishte më mirë sikur të pohonte diçka më të qartë në faqen e fundit, dhe së paku të ishte i parë që po zgjidhte enigmën? Së paku ashtu do të lexonim më të qetë romanin.

Kadareja jep variante të ndryshme rreth ardhjes së Doruntinës dhe sjellësit të saj në shtëpinë e së ëmës. Thekson që atë e solli Kostandini pas ngritjes nga varri, se erdhi me shitësin e ikonave, i

cili e kishte mashtruar atë vetëm për ta pasur pranë gjatë udhëtimit trembëdhjetë ditor dhe të mund ta pushtonte zemrën e saj, se erdhi me të dashurin e saj enigmatik, ngaqë ishte lodhur nga burri dhe nuk mund të duronte mallin dhe largësinë për familjen, e solli i vëllai për ta përmbushur ndjenjën e incestit të pakryer në të gjallë, e solli vetë fryma e Kostandinit, apo e solli vetë Stresi, i cili duke ditur që dikur kishte qenë i dashuruar marrëzisht pas saj, ndjente veten të çuditshëm dhe vendin të njohur, aty ku kishte zbritur Doruntina nga kali. Të gjitha këto jepen, por asnjëra nuk është më (pak) e besueshme se tjetra. Të gjitha pranohen, por në fakt asnjëra. Sillemi rreth të gjithave, dhe në pamundësi zgjedhjeje pranojmë si Stresi, që Doruntina erdhi me të vëllanë, i cili kapërceu vdekjen dhe varrin dhe atë e solli pranë së ëmës.

3.4 RINGJALLJA DHE KULTI I BESËS (ANALIZË NDRYSHE)

Romani i Kadaresë “Kush e solli Doruntinen” ka në focus një personazh që ringjallet. Ringjallja e Kostandinit është kyçi i librit “Kush e solli Doruntinen”. Ai dëshmon se fuqia e njeriut mund të jetë e barabartë me të hyjnive. Pikërisht shpresa e një rilindjeje, besimi i një ringjalljeje të njeriut, të energjisë dhe shpirtit të tij, në një kohë kur rreziku i shuarjes së individit në bashkësi ishte evident, duket se ka qenë joshja e autorit. Kapërcimi prej ringjalljes biblike te ringjallja laike ishte një hap epokal, ndoshta po aq sa rrembimi i zjarrit perendive në hershmëri apo dalja e njeriut jashtë sistemit yjor sot. Ky akt, i cili në shumicën e rasteve ishte lenë në një sfond mistik, u trajtua në mënyrë mjeshterore në veprën e Kadaresë.

Në romanin e marrë në analizë Doruntinen e solli fjala e dhenë, thotë personazhi narrator kapiteni Stres që kryeson hetimet. Doruntinen e solli kulti, pra, besa shqiptare, nxitojnë moralistet. Doruntinën e solli pengu i incestit të pakryer, thonë psiko-kritiket. Doruntinën e solli një aventurier dashurie, një dikush i rastit, pohon njeri prej priftërinjve. Nëse në të gjitha keto pohime ka dicka prej së vërtetës, mbetet pa u thënë thelbi: Doruntinën e solli Rilindja, era e furishme e ndryshimeve të saj, tronditja e moralit Mesjetës dhe kërkimi i një dhjate të re humaniste, rebelimi i mendjeve të fuqishme të kësaj epoke për t'i dhënë njeriut kuptim sublim; përpjekja e tyre për t'u bërë zotër të vetes, për të mbërritur te shën Njeriu. Atributi i ringjalljes,

kësaj radhe nuk ndodh në versionin biblik, Por sipas një balade laike të vendit. Kostandini është, në mënyrën e vet, një Mesi për bashkatdhetarët. Ai mberriti te perealizueshmen dhe u afroi njerëzve madheshtinë: kthimin nga vdekja, mundjen e saj, qoftë edhe në formë të reduktuar. Fryma e rilindjes dhe shpresa e përteritjes kanë krijuar historikisht energji shpirtërore të mëdha.

Kadareja ekspozoi një nënshtrat krejt të mosperfillur të kulturës kombëtare. Legjenda e Doruntines nuk ishte punë legjendash, por konkluzion i një epoke historike. Ajo shpallte lidhjet e lashta të kulturës së popullit tonë me ato te vendeve te qytetëruara të kontinentit. Në më pak se 50 vargje të parët e shqiptarëve jepnin e merrnin me një botë të tërë, benin krushqi gjer në Bohemi, lidhnin aleanca me baronë e fisnike të afërt e të largët, lëviznin të sigurt në gjithë hapësirën kontinentale. Ata ishin pjesë integrale e kësaj bote. Miqesitë e tyre gjendeshin nëntë male kaptuare. Të shkojë në viset gjermane apo dhe me tej për ta ishte njësoj si te thoshje: po shkoj në krushqi.

Në Shqipërinë e mbyllur, pa një mik, pa një aleancë, pa një portë të hapur, të fundit të viteve '70, kjo ekspozë mund të ngjallte zemërime e pakenaqesi, mund të shkaktonte inate e meri. Romani predikonte hapjen, kur politikanet kërkonin mbylljen e saj. Autori u paraqiste si një variant humanizmi bashkatdhetarëve të vet lashtësinë e rrënjëve të tyre, kur në vend zoteëonte një pikëpamje çuditërisht e ngulitur, sipas se cilës vlerat e vrteta ishin krijuar në gjysmëshekullin e fundit.

Mesazhi i Kostandinit është thirrja për një rilindje morale. Kthimi i pamundshëm i latinishtes i ngjan kthimit tragjik të Doruntinës dhe Kostandinit, i ngjan baladës së rikthimit nga varri, nga vdekja, për një kumt të ri në botën e këndejme, e cila, thjesht për një tekë gjuhësore u quajtkësh e të gjallëve. Dhe latinishtja rivjen, në gjurmën e gjallë të njerëzve të vdekur, si një "gjuhë e ftohur, (...), sillte shpirtësinë e fundit të një brezi njerëzor që po shuhej". Lufta e gjuhëve. Kështu quhet sot në gjuhën shkencore mishmashi i kacafytjeve gjuhësore në gjirin e njerëzimit.

KREU I KATËRT

IV. KATEGORIZIMI I PERSONAZHEVE DHE SPECIFIKAT E TYRE

Në romanet kadareane hasen personazh, që nuk kanë emër dhe mbiemër, por që thërrihen me ndonjë nofkë, zakonisht në përshtatje me profesionin që ushtron apo cilësi fizike që e karakterizon, etj. Megjithatë, fakti që ata nuk kanë emër dhe mbiemër nuk i bën më pak të rëndësishëm. Në rastin konkret, pra, te Doruntina nuk ia dinim emrin, ndihmësit të Stresit, ai gjatë gjithë veprës paraqitet si “ndihmësi” pastaj ishte shitësi i ikonave, ishin vajtojcet etj.

Përveç këtij grupi personazhesh, në veprën e tij hasim edhe personazhe që nuk janë të pranishëm në kohën e veprimit, por që edhe ata luajnë rolin që u caktuar autori. Në rastin konkret i tillë është Konstandini, i cili nuk jeton është i vdekur, por që luan rol qendror në vepër, madje ai është i pranishëm që në fillim gjer në fund të veprës. d.m.th vepra hapet dhe mbyllet me të. Të njëjtit grup i takojnë edhe vëllezërit e Konstandinit, të cilët nuk veprojnë në vepër, por që herë pas here përmenden.

Një lloj tjetër personazhesh, që është edhe më i rralli janë personazhet kolektiv, siç janë vajtojcet dhe shokët e Konstandinit. Tani, duke u mbështetur në pamjen e tyre, psikologjinë, vendin që zënë në vepër, rolin që luajnë aty të shpalosim disa prej tyre pikërisht ata me të cilët mendojmë që ka ecur vepra.

Doruntina - është personazhi më i bukur, më tërheqës dhe më tragjik. Megjithëse, pamjen e saj të jashtme autori e thekson fare pak, ne dimë që ajo ishte një vajzë e bukur, me një trup të hollë dhe një fytyrë të bardhë engjëlllore, kurse flokët e saj ishin të verdhë andaj disa herë në vepër e hasim si “leshverdha”. Ajo që të bën më shumë përshtypje te personazhi i Doruntinës është durimi që disponon ajo si dhe qetësia përballë shumë hidhërimeve. Të lë përshtypjen sikur u është dorëzuar ligjeve të jetës dhe nuk proteston për asgjë, sepse e konsideron të kotë. Gjithashtu konsiderohet si personazhi më tragjik i veprës. Gjatë gjithë kohës shohim ta kenë ndjekur fatkeqësi, duke filluar që nga martesja e largët, deri te kthimi për t’u përqaftuar me vdekjen.

Edhe pse zë vend qendror në vepër, Doruntinën e shohim të flasë pak, sepse gjatë gjithë veprës flet autori në vend të saj. Fjalët e saj të vetme do kenë qenë “Konstandini”, “po”, “jo” ose vetëm një pohim me mbylljen e syve. Sidoqoftë, ajo hyn në grupin e personazheve që flasin pak, por thonë shumë. Vendi i saj në familje gjithashtu ishte i rëndësishëm. Ishte vajzë e vetme e familjes Vranaj, motër e nëntë vëllezërve, shoqe e një të huaji nga Bohemia. Doruntina zë pak vend në faqet e romanit, sepse ajo ikën shumë herët, sapo zbulohet sjellësi i saj. Megjithatë, figura e saj është më delikata më e bukura dhe më tragjika njëkohësisht.

Konstandini - personazh që nuk është prezent gjatë veprimit të ngjarjes në vepër. Edhe pse i vdekur ai luan rol të madh në gjithë zhvillimin e ngjarjes, me një fjalë; ai edhe pse jo fizikisht, është prezent në vepër që nga fillimi deri në mbyllje. Ai është vëllau më i vogël prej gjithsej nëntë djemve që kishte familja Vranaj. Në veçanti na kujtohet për nguljen këmbë që motrën ta martojë larg vendit. *“Ai i pranonte martesat në vendet e largëta, fliste kundër kishës bizantine dhe nuk kishte ndonjë nderim kushedi çfarë për fenë”*⁴³

Ndërkaq, përveç këtyre tipareve, atë më së shumti, e karakterizonte qëndrimi dhe dashuria ndaj besës, gjë që e mësojmë nga vetë shokët e Konstandinit në bisedë me Stresin. Sipas tij besa shqiptare, që është brenda shpirtit njerëzor ishte shumë më me vlerë, ishte shumë më e fortë se ligjet që ekzistonin në institucionet shtetërore. Sa i përket pamjes së tij të jashtme autori nuk ka dhënë ndonjë përshkrim. Mbase e ka llogaritur të parëndësishme këtë gjë. *“Konstandini është figura e të vetmit disident në galerinë e personazheve kadareane..”*⁴⁴

Stresi -personazhi më aktiv dhe më enigmatik në vepër. Luan rolin e kapitenit, udhëheqësit të rendit. Detyra që ushtronte e bënte të gëzojë respektin e të gjithëve. Është enigmatik për faktin që kishte kohë që po i shtypte kokën dashurisë së ndaluar që ushqente për Doruntinën, dashuri kjo që e detyron të dalë jashtë rregullave jetësore dhe ato të detyrës. Fakti që ai jep dorëheqje, na bën të kuptojmë që ai ka shkelur aty ku nuk duhej, dhe për këtë veprim e kishte të qartë fare mirë që s’do gjente mirëkuptim, andaj largohet nga detyra dhe nga vendi për të mos u parë më.

Ndihmësi - njeriu më besnik i kapiten Stresit. Edhe pse në disa raste me hetimet që bën sikur luan rol kyç në zbulimin e enigmës mbi sjellësin e Doruntinës, në të vërtetë nuk luan asnjë rol.

⁴³Tefik Çausi, KADARE-Fjalor i personazheve, f. 164

⁴⁴Ismail Kadare, Kush e solli Doruntinën ,f.34

Vajtoicat - përbënin grupin e grave naive, të cilat në këtë rast mbase ishin të vetmet që vërtet besuan në ringjalljen e Konstandinit. Ata nuk luajtën ndonjë rol të rëndësishëm në ngjarje përveç që kryen në mënyrë profesionale vajtimet mbi Doruntinën dhe nënën e saj.

Dimë që: “*Personazhi është një nocion kompleks, është si një krijesë, lindja e të cilit, vjen si pasojë e marrëdhënies së ngushtë të romancierit me logjikën e universit krijues.*”⁴⁵ Personazhet e Kadaresë kanë funksione përshkruese dhe tërheqëse. Në romanin në fjalë personazhet gjatë rrëfimit dalin me **karakterizim të kombinuar** (rrëfim i narratorit dhe i vetëzbulimit të personazhit). Pastaj kemi **karakterizim të jashtëm dhe të brendshëm**⁴⁶ - në rastin e Zonjës Mëmë dhe Vajtojçave, si personazhe kolektive. **Karakterizim me anë të një fjale apo fraze**⁴⁷ - në këtë roman është fjala për ringjalljen dhe besën.

Narracioni i romanit “*Kush e solli Doruntinën*” është i ndërtuar mbi historinë e një familjeje shqiptare, apo thënë më qartë, rreth mitit të *besës*. Toposi i temave dhe rrjetit narrativ në strategjinë tekstore sillet rreth kësaj enigme, ndërkaq në këtë bosht/mit defilojnë një mori personazhesh të infiltruar në vdekjen dhe mistere, në ngritjen prej varri, mbase edhe në mbajtjen e kësaj jete pas një vdekjeje në heshtje të anktshme dhe të pasqarueshme me teoritë e asnjë shkencë. Ndërkaq në anën tjetër ndeshen edhe situatat tjera interesante të përfaqësuar nga heroit vajzë i këtij romani Doruntina. Madje një ndikim i prozës së mbështetur në mite dhe në letërsi popullore hetohet në tërë rrëfimin, fakt që tregon influencën e madhë që autori ka marrë folklori i pasur shqiptar. Nga këndej një galeri e tërë personazhesh dhe nivele të ndryshme të rrëfimit defilojnë në këtë roman në trajta të ndryshme. Autori krijon një mori karakteresh që përshkruhen me imtësi. Mbetën thellë në mbamendje të lexuesit personazhet sikur Nënë Lokja, Stresi, etj. “*Letërsia është një urë shpirtërore si e dërguar nga Zoti për të bashkuar njerëzit dhe popujt, me shumë e më tepër forcë se çdo lidhje e aleancë tjetër. Prandaj, ajo duhet ndihmuar të dalë nga izolimet e të qarkullojë lirshëm*”⁴⁸.

⁴⁵ Arlind Farizi, (2015), *Tipologjia e personazheve në romanet e Ismail Kadaresë*, Tringa desing, Tetovë, f. 31.

⁴⁶ Po aty, f. 66.

⁴⁷ Po aty, f. 74.

⁴⁸ Çiraku, Ymer, *Gjurmime në letërsinë shqiptare*, Albas, Tetovë, 2003, f.3

Ajo që e përbën intencën themelore të romanit ndërlidhet me domosdonë që siç thotë narratori të “*zbulojmë një lakuriqësi, e cila po na ndjek si hije madje deri në varr është fjalë e dhënë.*” Në këtë pikëpamje, autori sikundër le të kuptohet një domosdo të *katharisit letrar*, që rezulton me fundin që autori i jep zgjedhjes së misterit, një triumf që lehtëson barrën e rënd lidhur me ardhjen nga varri të Konstandinit.

4.1 PERSONAZHI NARATOR

Narratori i romanit, që njëkohësisht është vetë heroi letrar Konstandini, nëpërmjet reminishencës rikthen personazhin e Konstandini në qendër të romanit. Intenca e romanit, ajo që në terminologjinë letrare njihet si fabulë, duke u ndërlidh me zbulimin e misterit të ardhjes së një të gjalli nga varri për hir të fjalës së dhënë. Për të sforcuar diskursin narrativ dhe për t’i dhënë kahe sa më universale fabulës, autori romanin e shtreson në shumë linja narrative. Nivelet e rrëfimit prekin shumë tema të ndjeshme, që nga emigrimi, vrasjet dhe gjakmarrjet, deri te dimensionet politike. Ndërkaq për të shtresuar tematikën në hapësira dhe kohë të ndryshme, mekanizmat narrativ në roman lëvizin dhe zhvillohen nga disa pozicione letrare. Në të vërtet, aty ndeshim disa zëra narrativ, të cilët rrumbullakojnë një narrativitet të kodifikuar mirë. Narratori i gjithëdijshëm e nis romanin, për t’ia lënë hapësirën narratorit/ personazh, i cili gjendet në kërkim dhe i cili e dominon romanin. Perceptimet për botën që e rrethon, autori i artikulon nëpërmjet perceptimeve të heroit letrar.

Shikuar në tërësi ky roman ka një fabulë të rrjedhshme. Zëri narrativ, ai që është treguesi në roman, rrëfen me një diskurs letrar të përpunuar dhe kjo është një cilësi letrare e dallueshme që e bën këtë roman të këndshëm për lexim dhe të bukur për shijim. Ajo që bën përshtypje është loja që autori di të bëjë më kodet e shumta letrare dhe paralettrare, me groteskun, krijimin e miteve, shtresime këto letrare, të cilat i japin romanit karakter universal dhe ku hasim trajtat e prozës së fuqishme universale. Këto dimensione shpërfaqin gjithashtu një aspekt intertekstual të prozës së Kadaresë, sikundër edhe një dimension interdiskursiv, që funksionalizohen për të përplotësuar intencën estetike të romanit.

Personazhet e paktë të romanit kanë specifikat e tyre, me të cilat njihen para lexuesit, por pavarësisht enigmës së romanit që nuk zbulohet askund, ata përcjellin te ne mallin, dashurinë, dhembjen, mbajtjen e fjalës, sinqeritetin etj.

KREU I PESTË

V. ENIGMA DHE DILEMA MITIKE

Kadareja me këtë vepër dëshmon kryerje të aktit të ndërgjegjshëm intelektual të dashurisë për kanunet e shtetit të tij, për kodet tradicionale.

Është balada mbi “Motrën me nëntë vëllezër” të cilën Kadare e sjell para lexuesve me titull “Kush e solli Doruntinën ” titull ky që është më goditës dhe më provokues. Megjithatë, secili nga ne pa e lexuar librin kërkon dhe pret që Doruntinën do e ketë sjellë i gjalli, ashtu është më e natyrshme te e fundit. Kështu, realisht beson gjithkush në fillim. Por, me të mbaruar së lexuari romanin në kokën e secilit ka hamendje, andaj, merr në duar përsëri librin, i bindur mbase që s’e ka lexuar me vëmendje, mbase se ka kuptuar mirë ose tek e fundit mund të shkaktohet një nervozizëm te lexuesi, i cili tjetër gjë pret, tjetër gjë. Kështu që kur të lexojë që Konstandini u ngrit nga varri nga njëfarë ”inati” të brendshëm mbase do kishte thënë... phaaa... ç’ thotë ky ?

Reagime të tilla më shumë mund të hasen te lexuesit e huaj. Jo që ata dinë më pak për mitin, por ata shumë më pak dinë për besën. Kurse lexuesi shqiptar, i cili e di ç’është besa shqiptare, do ta arsyetoj faktin që Kadareja ka shkruar kaq larg me çmendurinë e tij... “ringjalljen”. Për ta kuptuar më mirë veprën i duhet përkushtim dhe vëmendje. Aq më shumë që kjo është e kodifikuar dhe duhen deshifruar pjesët më të ngurta dhe më të fshehta në roman. Të shohim ca nga dyshimet që hasim aty.

- 1.Shokët e Konstandinit në atë kohë nuk kishin qenë në fshat.
- 2.Stresi gjithashtu dy javë kishte humbur pa lënë gjurmë.
- 3.Përderisa ruajtësi i rendit (Stresi) nuk ishte në gjendje të gjejë sjellësin e vërtetë, ishte e natyrshme që dyshimi të bjerë edhe mbi atë.
- 4.Tefik Çausi, gjatë analizës së tij që bën rreth romanit, Stresin e paraqet si një ndër më të dyshuarit: *“Gjatë përsiatjeve të tij për të gjetur se kush ishte ai njeri i panjohur, që dinte fort mirë vdekjen e vëllezërve, besën e Konstadinit dhe udhën që nga konteja e Evropës Qendrore*

gjer në Arbëri, Stresi psherëtin thellë dhe e përfytyroi rrafshin e paskaj evropian, ashtu siç e kishte parë gjatë të vetmit udhëtim atje...dhe nga shpirti i dolën, thuajse jashtë kontrollit dy fjalë: ‘falmë Zot ynë’ Le të na falë edhe ne kapiteni simpatik, ta pyesim, pse iu lut Zotit ta falte ç’mëkat kishte bërë? Përgjigjja e tij po të jetë e singertë, do të na i sqarojë edhe psherëtimën e tij, edhe kur e ka bërë dhe me kë e ka bërë atë udhëtimin deri në Evropën Qendrore”⁴⁹

Për të përforcuar dyshimet që kemi mbi kapiten Stresin për mundësinë e të qenët vetë sjellësi i Doruntinës, të përkujtojmë pjesë nga vetë romani dhe mbase do kuptojmë që ai ka ditur të aktrojë në mënyrë të shkëlqyer rolin e tij, por që herë pas here pa dashje shohim të ketë nxjerrë nga goja ndonjë fjalë që s’duhet. Janë këto momente ku kapiten Stresi rrezikon të zbulohet.

- Është diçka e jashtëzakonshme, - tha ai.
- Pothuajse e pabesueshme, - ia ktheu ndihmësi.
- E mora me mend. Dhe në të vërtetë s’është për t’u besuar. Është vërtetë një enigmë.
- Më tepër se një enigmë, - tha Stresi. – Sa më tepër që e mendon, aq më e pakapshme të duket.

-Gjithë puna është të gjendet se si pati mundësi të vinte Doruntina, - tha ndihmësi.
- Si?
- Kyçi i enigmës është të gjendet se si erdhi Doruntina, me ç’njeri, apo, më mirë, me ç’ mënyrë.

- Me ç’njeri, - e përsëriti Stresi, - me ç’mënyrë... Është e qartë që ajo nuk thotë të vërtetën.

- *“Tri herë e pyeta se si erdhi, por ajo nuk jepte shpjegime. Diçka fshihte”...⁵⁰*

Një tjetër moment mjaftë interesant është ballafaqimi i Stresit me Doruntinën dhe Zonjën Mëmë, që edhe më shumë na i ngjall dyshimet mbi kapiten Stresin. Biseda mes tyre zhvillohet si vijon.

- *“Si jeni, Zonja Mëmë?*
Shenja që bëri ajo me sy ishte e pakuptueshme.
- *Doruntina ka ardhur mbrëmë? – pyeti Stresi.*

⁴⁹Tefik Çausi „Kadareja përmes pasqyrave,, f. 15

⁵⁰Ismail Kadare,, Kush e solli Doruntinën, f.14

E shtrira bëri “po” me sy. Pastaj sytë e saj vazhduan ta vështronin drejt Stresin, sikur kërkonin diçka prej tij. Stresi qëndroi ca çaste në mëdyshje.

Po si ndodhi? – pyeti ai fare ultazi. – Kush e solli? “

Plaka mbuloi sytë me njërën dorë dhe nga një lëvizje e kokës u kuptua se humbi ndjenjat⁵¹...

E tillë ishte edhe biseda me Doruntinën. Pak fjalë, por shumë domethënie. Të përkujtojmë një pjesë të bisedës që zhvilloi kapiten Stresi me Doruntinën.

- Doruntinë, - i foli rishtaz, - mirë se erdhe fisnike!

Ajo vazhdonte ta shikonte ngultazi.

- Si e ndien veten? – tha Stresi ngadalë dhe, pa e ditur as vetë pse, i zuri dorën. Dora e saj ishte e ngrohtë valë. – Doruntinë, - vazhdoi ai me zë fare të ulët, - ti ke mbërritur mbrëmë pas mesnate, apo jo?

Ajo bëri një “po” me sy. Stresi deshi ta shtynte edhe pak pyetjen që e mundonte, por ajo i doli vetvetiu.

- Po kush të solli?

Sytë e saj mbetën të palëvizshëm nën vështrimin e tij.

- Kush të solli, Doruntinë? – përsëriti ai. Zëri i vet i ngjau i huaj. Dhe pyetja ishte aq e frikshme saqë pati ndjesinë se deshi ta kthente mbrapsht. Por tani ishte vonë.

Ajo nuk ia hiqte sytë, me atë boshësi të pashpresë në mes.

Tani shko gjer në fund i tha vetes.

- Ti i the nënës se të solli yt vëlla, Konstandini, apo jo?

Ajo bëri prapë “po” me sy. Stresi u përpoq të gjente shenjat e çmendurisë në sytë e saj, por ata, si edhe më parë, ishin të zgropët.

Po ti ndërkaq besoj se e ke marrë vesh që yt vëlla ka tre vjet që s’është më, - tha Stresi me po atë zë të shuar. Lotët, përpara se t’i shihte tek ajo i ndjeu brenda vetes. Ishin ca lotë tjetërllor, gjysmë të prekshëm. Në atë lotëri fytyra e saj u bë edhe më e largët. Ç’ më gjeti kështu, dukej sikur thoshin tani sytë e saj. Pse s’ më besoni...⁵²

5. Dyshimi tjetër vjen nga fakti që Doruntinës, personi që shkoi ta merrte iu duk si Konstandini, (pra, vetëm iu duk), sepse ai që aq i kujdesshëm dhe nuk lejoi që ajo të vërtetohej aq mirë. Ai madje nuk zbriti as nga kali dhe nguli këmbë që ajo të ngutej e të nisej ashtu siç

⁵¹ Po aty f.21

⁵² Ismail Kadare, Kush e solli Doruntinën, f.24

ishte. Me fjalë të tjera asgjë nuk ishte siç duhej në këtë rast, sjella e Konstandinit nuk ishte aspak e natyrshme andaj edhe lind dyshimi.

6.Dyshimi i rradhës që gjithashtu lidhet me Stresin ka të bëjë me shqetësimin e madh që kishte ai kur dëgjoi se kishin ardhur dy kushërinjtë e burrit të Doruntinës për t'u informuar rreth saj që ka ndodhur.

7.Një moment tjetër që dyshimet mbi Stresin i forcon edhe më shumë është te shtëpia e Vranjave, të cilin Çausi e ka kapur aq detaisht: “Me kancelarinë e princit dhe me kryepeshkopin Stresi mund ta vërtiste vallen sa të donte. Kurse me diçka tjetër e me dikë tjetër s’kishte si t’ia bënte. Kjo ishte shtëpia e Vranjave dhe aq sa qenë të përhimtë e të thellë pus, aq qenë dhe dëshmitarë okularë.Kur Stresi iu afrua asaj për ta pyetur, sytë e plakës e vështruan drejt sikur kërkonin diçka prej tij.Dhe më tej kur e pyeti: kush e solli Doruntinën, plaka mbuloi sytë me njërën dore dhe humbi ndenjat.Ishte Mëma, pra, që kërkonte diçka prej tij; ai s’kishte të drejtë të pyeste.Megjithëse ajo i mbuloi sytë, prej tyre dukej se dilte një dritë e fortë, që përplasej mbi trupin e kapitenit, si në ato ngjarjet policiësk, ku i ndjekuri mbërthehet me dritën e projektorit.”. Pra, nga kjo që përshkruan Çausi, Stresi duket sikur s’ka ku ikë, gjithçka është kundër tij, andaj edhe se përballonte dot shikimin me Zonjën Mëmë, e cila mbase është e vetmja që di sjellësin e vërtetë, por që nga tronditja ra në shtrat dhe tani detyrimisht mbetemi ende te Konstandini, tek i vdekuri.

8.Ndihmësi njofton Stresin se është kapur sjellësi i Doruntinës (shitësi i ikonave), ndërsa ai nuk shfaq gëzim, vetëm tronditet duke thënë SI ËSHTË E MUNDUR!

9.Kështu pra, ditët po kalonin situata po bëhej e padurueshme, ndërsa dyshimet mbi Stresin shtohen edhe më shumë. Andaj ai do të caktoj një mbledhje ku edhe do të flas për t’i dhënë fund çështjes, ose për t’iu dorëzuar legjendës ngase nuk munda ndryshe, ai do të deklarojë para të gjithëve që Doruntinën e solli besa, e solli Konstandini, s’është me rëndësi si dhe në ç’mënyrë por ajo u soll dhe besa e dhënë zuri vend. Nga kjo që tha pati reagime dhe u shkaktua njëfarë nervoze, sidomos te kryepeshkopi. Atëherë Stresi përveç që nuk sheh ndonjë rrugëdalje, ndjen edhe obligim moral të tërhiqet nga detyra që i është caktuar, andaj shkëlqon nga zhguni i tij shenjën me brirët e bardhë të dhisë dhe e hedh poshtë që nënkupton dorëheqjen e tij.

10. Pas mbledhjes, s’që e vështirë që dikush nga turma me një zë të drithëruar, siç i ndodh njeriut kur ngjethet nga të ftohtit, të thoshte: nganjëherë me vete mendja se mos ai vetë (është fjala për Stresin) e ka sjellë Doruntinën.

11.Megjithatë, sido që të kuptohet romani, të besohet që ishte Stresi që e solli, ishin shokët e Konstandinit, apo vërtet u ringjall Konstandini nuk do ia kishim zënë për të madhe shumë njëri-tjetrit, sepse ky është një roman i kodifikuar, kodet janë pikërisht dyshimet që ngjall Stresi te lexuesi, të cilat si dallon po që se nuk e merr për së dyti librin në duar. Madje, edhe ai që e krijoi këtë vepër shumë herë i ka shtruar vetes pyetjen se kush e solli Doruntinën. Në veprën e tij “Ftesë në studio” ai shprehet se shumë herë është pyetur nga lexuesit dhe kritikët për sjellësin e Doruntinës.. Megjithatë edhe ai nuk ka pasur një përgjigje të prerë, por si më të afërt për këtë thotë që e ka ndjerë Stresin.

12.Duket që më në fund ia dolëm, gjetëm sjellësin e Doruntinës dhe tani mund të marim frymë thellë: Mirëpo, në momentin që po shkulum frymëmarrjen nga mushkëritë, me gjithë forcën e organeve të frymëmarrjes ajo na ngelet në fyt sepse po në atë moment si për inat na del përpara syve një ...PSE? Dreqi ta marrë them me vete, po ç'rëndësi ka tani kjo. Mundohem ta bind vetëm që kjo s'ka aspak rëndësi, them që e gjeta kush e solli dhe, pse e solli dua domosdo ta bind veten që s'ka rëndësi. Por, fatkeqësisht s'po ia dal dot. Sado që mundohem të mos e përfill këtë pyetje, vë duart në vesh, bëhem sikur s'dëgjoj, shtirem dhe ik prej saj, shoh që ajo vrapon pas meje duke më thënë unë dhe vetëm unë jam thelbi i gjithë asaj që ke lexuar, andaj mos më anashkalo, por përgjigju PSE e solli Doruntinën??? Pse?

Sipas meje shkaku që pikërisht Stresi e solli Doruntinën ishte dashuria që prej kohësh ushqente ndaj saj, por që e fshihte aq mirë për shkak të detyrës që kishte dhe gjithashtu për arsyen tjetër që ishte i martuar. Nga kjo mund të themi që Doruntinën e solli dashuria, që në vete padyshim që ka besën. Andaj, themi që e solli besa, e solli dashuria apo Stresi është e njëjta gjë. Ndërkaq, antipatia apo xhelozia që shfaq shoqja e Stresit sa herë që dëgjon emrin e Doruntinës është një fakt më shumë për dashurinë e fshehtë që kishte Stresi, të cilën e shoqja mbase e kishte nuhatur qysh herët që atëherë kur u largua Doruntina nga fshati, po edhe pse shumë herë ishte përplasur me Stresin për këtë gjë, asnjëherë nuk i plasi në fytyrë gjërat që mbase i dinte, sepse nuk i konvenonin aspak krenarisë së saj.

13.Tani që shtruan gjithë këto fakte dashurie, duket sikur i shtypëm kokën një çik besës dhe padyshim lexuesi do pyet veten në moment. Tani ç'është tema e këtij romani? Ç'është kryesore këtu? Ç'ka dashur të theksoj autori? Besën apo dashurinë? Sado që të tundim kokën për këtë se bëjmë dot, sepse janë të dyja bashkë, besa dhe dashuria apo dashuria dhe besa, që s'bëjnë

dot pa njëra tjetrën. Këtë se ka sqaruar askush më bukur se Tefik Çausi. Madje as vetë Kadare s'ka arritur ta sqaroj kështu:

“Gjykatësi: (Stresit) i akuzuar (shkruesit të proçesverbalit) Prishe këtë fjalë...(Stresit) I dashuruar, prano se nuk ke thënë të vërtetën, prano se e ke dashur Doruntinën.

Stresi: Pranoj se nuk kam fshehur asgjë.

Gjykatësi: Ke shumë të fshehta nën zhgun. Hiqe zhgunin.

Stresi: Dashuria gjen strehë në vende të tjera, më të fshehta.

Gjykatësi: Përse, atëherë, i the gjindjes së Doruntinën e solli besa, pse s'i the të vërtetën?

Stresi: Vallë, Besa s'e ka brenda dashurinë. Dhe dashuria nuk është vallë besa?

Gjykatësi: I dashuruar, shpjegohu!

Stresi: Zotëri, të gjithë jemi pjellë e dashurisë...

Gjykatësi: E pastaj...?

Stresi: Kur biem në shtrat, bëjmë dashuri, të tjerat vinë pas.”⁵³

Ai kërkon te mitet, (sikurse edhe sivëllezërit e tij, Fishta e Camaj) nevojën për të përtërirë mrekullitë ribërëse e ringjallëse të vetës e të vendit të tij, duke besuar te principi se *mitet janë manifestime kulturore të nevojës universale të psikës njerëzore, për të shpjeguar realitete sociale, historike, kozmologjike e shpirtërore*. Po ashtu, duke besuar se mitet janë hapësira më autentike e shpirtit të veprimeve, dashurive dhe mendësive tona, janë pasqyrat ku sheh veten **Vetëvetja** jonë e lashtë (uni + tërë ndërgjegjet e pararendësve tanë të kthyer në simbole). I sigurt për truallin psikomitik ku lëviz (gjallon) shqiptari i civilizuar dhe ai “arkaik”, Kadare luan me personalizimin e miteve (Kush e solli Doruntinën), kërkon transhendencën, nga qenia te miti dhe anasjelltas, për të treguar normalitetin e hapësirës (reale-ireale) ku lëviz, sipas nevojës, qenia shqiptare (ballkanike apo edhe mesdhetare). E ndërtuar thjesht, pa veprim, por me dialogë, të cilët nxiten vetëm me forcën e një simboli, që ngacmon kujtimin mbi lashtësinë e fisit dhe të drejtat tona zakonore, romani “Kush e solli Doruntinën” sjell futjen e një fakti mitik prehistorik, jo vetëm shqiptar: vizionet, që merr *ffjala e dhënë, Besa* në momente të rëndësishme për individin dhe kolektivin. Këto vizione, që do të bartin ndjeshmëri dyfishe (ogurmire dhe ogurzezë) në varësi të kontekstit kur ajo përdoret. Edhe në sistemin mitik të Kadaresë identifikuese e veprës mbetet besa, e cila për analogji, është identifikuese edhe në sistemin mitik të prozës popullore

⁵³Tefik Çausi, Kadareja përmes pasqyrave, Onufri, Tiranë, 2010, f. 34

shqiptare. E sigurt dhe e besueshme se është e jonë dhe shqiptare, identitet kulturor i pakontestueshëm. Retorika e përdorur kadareane dhe asociacionet që ajo krijon Brenda tesktin romanor e përforcon besimin se:

***“Besa e ngriti të vdekurin nga varri”.* Dyshimi, para këtij pohimi e bën të mistershme vetë aktin e rringjalljes nga fakti se vetëm Jezu Krishti është ngritur nga varri dhe jo qenia e zakonshme dhe të vdekshme...**

Tashmë *ringjallja* është një ndërgjegje kolektive që e ka pranuar ideologjikisht dhe fetarisht por në romane lejohen rregulla tjera, këtu dominojnë fiksionin e jo faksioni.

Pyetjes, nëse miti parathotë realitetin apo autori sugjestionon, mund t’i përgjigjemi se në fakt është miti që flet, se ai, siç thotë *Frojdi*, zbulon fiksime psikologjike të përvojës dhe dëshirat që mbeten të fshehura te qenia njerëzore. E ne, thjesht, ne si lexues e studiues duhet t’i lipset ti interpretojmë. Dhe interpretimi duhet të bëhet sipas kuptimit të brendshëm, që lidhet me përvojën e atij kolektivi (kombi). Kodi individual në rastin e romanin “Kush e solli Doruntinën” është dashuria e madhe e vëllait ndaj së motrës, e cila është edhe në referencë në sistemin mitik universal. E njëjta gjë ndodh edhe te romani “Kush e solli Doruntinën” megjithëse këtu kemi të bëjmë me një subjekt, që ngrihet mbi bazën e fjalës së dhënë, ku ka depërtime sonduese në nënvetëdijen e një kolektiviteti; te ligjësitë e pashkruara, të subtlia, të dashuria. Interpretimi i kësaj dashurie mund të merr një përvojë të njohur në psikën e shqiptarëve: shpërdorimi i besës ose incestin. Paktmarrëveshja që bën Kadare me personazhin e tij është prova për ruajtjen e një kodi të shenjtë, të trashëguar në nënndërgjegjen kolektive, atë të besës dhe nuk lejon keqinterpretime të barazimit të saj me incestin...).

Një ndër romanet që është i bazuar në mitet e lashta dhe baladat popullore është “Kush e solli Doruntinën” nga Ismail Kadare. Këtu hasim “mitin e ringjalljes” dhe “mitin e besës” të cilat autori i sjell jo vetëm të transformuara por edhe të modernizuara.

Subjekti me pak fjalë është ky: Doruntina është një vajzë e re e familjes Vranaj që është martuar shumë larg familjes së saj, në Bohemi. Vëllai i saj, Konstandini, i kishte bërë një betim nënës së tij se do ta sillte Doruntinën sa herë që asaj t’i nevojitej. Tre vite më vonë, pas vdekjes së tij, nëna qan te varri i tij dhe e mallkon për fjalën që se pati mbajtur. Një ditë Doruntinën e merr

dikush dhe e sjell me kalë pranë nënës. Ajo e pavetëdijshme për vdekjen e vëllezërve të saj tregon se ai që e ka sjellë ishte Konstandini. Të shokuara të dyja gjejnë vdekjen.

Ekzistenca e pavarur e mitit, me anë të të cilit motivohet bindja te pagabueshmëria e rrethit të shenjave që shfaqin personazhet Doruntina dhe Konstandini, para se të përcaktojnë fatin njerëzor, përbën fillin e lidhjes të romanit. Besimi te sistemi mitik i këtyre elementeve të quajtura paganë është më i fuqishëm se besimi te çdo lloj religjoni. Rrëfimi që zhvillohet në mes bartësve të këtyre dy besimeve, Doruntinën (bartës i sakrificës personale për hir të asaj kolektive) dhe Konstandinit (bartës të mitit) bëhet në: rrafshin pohues: “kthimi u realizua, fjala u mbajt... Dhe në rrafshin mohues - dilematik: **Kush e solli?, i vdekuri ajo i gjalli?**, apo Stresi... dhe konstatimi tjetër dhe sërish pohues: atë e solli besa, fjala e dhënë... Kjo e fundit rrëfen situatën origjinale, kundërshton procesin e transfertës të besimeve brenda truallit të populluar nga mitet.

Miti i ringjalljes vjen në jetë në roman në momentin kur Doruntina pandeh se e ka sjellë Konstandini, i cili rezulton i vdekur prej tre vitesh. Kjo ringjallje e mundshme e Konstandinit për të sjellë motren e tij dhe për ta mbajtur fjalën e dhënë para shumë vitesh është një moment shokues për lexuesin. Përshkrimi që autori i bën Konstandinit gjatë udhëtimit, si të mbuluar me pluhur e me baltë, e çon lexuesin drejt mendimit se Konstandini vërtetë është ringjallur nga varri, e ka sjellë të motrën në shtëpi dhe më pas, ashtu siç përshkruhet, me arsyen se do të ndalet pak në kishë, ai e ka lënë të motrën te dera e shtëpisë dhe është larguar për të hyrë sërish brenda varrit.

Kjo dukuri nuk është shokuese jo vetëm për lexuesin por edhe për popullin (personazhet) në roman. Kisha nuk mund të lejonte që populli të mendojë se dikush tjetër pos Jezu Krishtit është ringjallur, prandaj ata e urdhërojnë Kapiten Stresin që të hulumtojë dhe të nxjerrë një përfundim tjetër të bazuar në fakte që do ta provonin se askush nuk është dhe nuk mund të ringjallet pas Krishtit.

Miti i besës vjen në jetë pikërisht kur populli pandeh se Konstandini është ringjallur. Ai është ringjallur për të mbajtur besën që i pati dhënë nënës së tij kohë më parë se do ta sillte Doruntinën në ditë gëzimi e vaji. Kaq i fuqishëm është kulti i besës së dhënë te shqiptarët sa ta çojë dikë nga varri. Kjo është dilema apo enigma e krejt veprës, çfarë ndodhi me të vërtetë me Doruntinën? Kush e solli atë?

5.1 ÇKA INVESTIOGONTE KAPITEN STRESIT?

Investigimet e Kapiten Stresit janë domethënëse për studimin e romanit. Ato ishin të shumta, ai kalonte shumë netë pa gjumë duke u munduar t'i japë kësaj çështje drejtimin e duhur. Fakti se roja i varrezave e kishte parë Zonjën e Vranajve të mallkonte të birin që ndodhej në varr, për arsye se nuk e pati mbajtur fjalën, e komplikonte shumë ngjarjen. Ky mund të ishte një argument i fortë për t'u siguruar se Konstandini u ringjall. 1. Për të mbajtur besën e dhënë, 2. Për të shuar mallkimin e nënës së tij dhe për t'u prerë i qetë në varr. Por, Stresi ishte i detyruar nga kisha të provonte se Konstandini nuk është ringjallur.

Stresi ndërmori hapa të rëndësishëm që kjo enigmë të zgjidhej sa më shpejt. Ai u mundua disa herë të bisedojë me Doruntinën në lidhje me ngjarjen por ajo bashkë me nënën e saj dergjeshin në shtrat nga tronditja. Ishte e dyshimtë, Doruntina u trondit pas lajmit të vdekjes së vëllezërve të saj. Po nëna pse u trondit aq shumë? Mos vallë ajo e pa personin me të cilin Doruntina kishte ardhur? Mos vallë, atë e kishte sjellë dikush tjetër? Ky ishte çelësi, kjo ishte zgjidhja e enigmës në duart e Stresit. Sikur të gjenin dikë që pohonte se kishte sjellë Doruntinën, pasi kishte me të një lidhje intime dashurie, do të hidhte poshtë aludimet se Konstandini është ringjallur.

Po çka sikur kjo të ishte e vërtetë? Sikur nëna të jetë tronditur kur e pa të bijën që e solli një dashnor? Stresi nxitoi të fliste me zonjën e Vranajve por u vonua, ajo bashkë me Doruntinën kishin ndërruar jetë!

Pas disa javësh në fshat shfaqet bashkëshorti i Doruntinës, i cili tregon se Doruntina i kishte lënë një letër ku shkruhej se po ikte me të vëllanë. Po sikur Doruntina të jetë mërzirur 3 vite martesë në Bohemi dhe të ketë filluar një aventurë dashurie me dikë tjetër?

Kjo gënjeshtër iu servir popullit, megjithëatë ca e besuan e ca të tjerë jo! Kisha madje gjeti dikë dhe e punësoi për të dëshmuar se ka pasur lidhje intime me Doruntinën, por kjo nuk e zbehu të vërtetën, se ndoshta realisht Konstandini ishte ringjallur dhe puna e të dashurit ishte thjesht një trillim. Kapiten Stresi edhe pse u bë pjese e mashtrimit të popullit ai nuk e mashtroi dot veten, pasi thellë brenda vetes ai e dinte që ajo histori nuk ishte e vërtetë dhe doli në përfundimin se ishte vërtet Konstandini ai që e solli Doruntinën dhe besa e tij që i pati dhënë nënës.

5.2 NDËRTEKSTORIA SI VLERË E ROMANIT MODERN

Ndërtëkstoria është një element letrar që shërben për të krijuar vepra. Me anë të ndërtëkstorisë një autor krijon një vepër letrare duke u bazuar në një vepër të lexuar më parë. Kështu kemi vepra që s'mund të kuptohen pa qenë më parë të njohur me veprën të cilës është bazuar autori. Kështu “Kush e solli Doruntinën” nuk mund të kuptohet pa e njohur baladën e ringjalljes dhe kultin e besës të shqiptarët.

Te “Kush e solli Doruntinën” hasim shumë elemente të traditave e zakoneve shqiptare. Një ndër ta është martesë me mblesëri, e cila është praktikuar që në kohërat e lashta dhe vazhdon të praktikohet edhe sot nëpër vise të vogla shqiptare ose fshatra të izoluara. Element tjetër është zakoni që vajza e martuar qoftë larg familjes ose afër saj, duhet të jetë prezente gjatë vajtimeve (ditëve të këqija) dhe gëzimeve (ditëve të mir). Shkuarja në luftë, ashtu si vepruan vëllezërit e Doruntinës dhe dhënia e jetës për atdhe është një nder i madh për shqiptarët dhe kjo ka qenë dikur traditë e çdo familjeje shqiptare.

5.3 STUDIMI I VEÇANTË PERSONAZHIT TË STRESIT

Po sjellim dhe disa shembuj të **rendit të njësive fabulare-kompozicionale**

1. Komunikimi i lajmit të çuditshëm Stresit nga ndihmësi. Shkuarja e tyre në shtëpinë e Vranajve dhe biseda gjatë rrugës;
2. Kujtimi i Stresit për varrimin e nëntë vëllezërve të Doruntinës;
3. Vizita e Stresit Zonjës Mëmë dhe Doruntinës, biseda me to;
4. Raporti i Stresit dërguar kancelarisë së princit;

5. Dilemat dhe hipotezat e Stresit. Shkuarja e tij bashkë me ndihmësin në varreza: lëvizja e gurëve të varrit. Betimi i Stresit se do ta gjejë sjellësin e vërtetë;
6. Urdhëresa e Stresit dhe shpërndarja e saj, hamendjet dhe dyshimet e Stresit;
7. Shkuarja e dytë e Stresit te Doruntina, biseda me të, pohimet rrëqethëse të saj. Pohimi se nuk ia ka parë fytyrën Konstandinit gjatë udhëtimit;
8. Ardhja e raporteve nga terreni dhe shterpësia e tyre, angazhimi i ndihmësit për të hulumtuar në arkivin e familjes Vranaj. Biseda e Stresit me gruan e tij për Doruntinën;
9. Ardhja e letrës nga princi, xhelozia dhe mëria e gruas së Stresit për Doruntinën;
10. Ardhja e rojtarit dhe njoftimi i tij se kishte lëvizur varreza;
11. Shkuarja e Zonjës Mëmë në varreza, dy javë para se të vinte Doruntina dhe mallkimi i saj mbi varrin e Konstandinit;
12. Shkuarja e Stresit për të biseduar me plakën dhe dëgjimi i kujës që njoftonte vdekjen e Doruntinës dhe së ëmës;
13. Ardhja e njerëzve në varrim nga të katër anët, vajtimi i vajtojcave, analiza e raporteve që ia kishin sjellë për to dhe pohimi se në sytë tanë po lind një legjendë e re;
14. Shkuarja e Stresit në varrim;
15. Kujtimi që ia nxit kortezhi për krushqit në dasmën e Doruntinës;
16. Thirrja e Stresit nga kryepeshkopi, shkuarja në manastirin e Tre Kryqeve dhe biseda me të;
17. Kthimi i Stresit, shikimi i eshtrave të një kali rrugës dhe dyshimi se mos janë të kalit të Konstandinit;
18. Meditimi i Stresit për mospërfilljen e kishës lindore nga Konstandini;
19. Ndërhyrja e Princit për shpejtimin e hetimeve, ardhja e dy njerëzve nga familja e burrit të Doruntinës dhe biseda e Stresit me ta;
20. Dyshimi i Stresit se mos ka gënjyer Doruntina dhe se ngjarja enigmë mund të jetë një aventurë dashurie;

21. Njoftimi i ndihmësit se kishte kryer me hulumtimin e arkivit, shkuarja e Stresit në shtëpi dhe akti i dashurisë me gruan;
22. Versioni i ndihmësit për incestin si shkak;
23. Vendosmëria e vajtojcave për të mos ndryshuar asgjë nga vajtimi, shkuarja e Stresit në varreza nëpër borë dhe ndërdyshja e tij;
24. Lajmi për zënien dhe dorëzimi i tregtarit ambulant të ikonave, mospranimi i tij, tortura, pranimi se e kishin paguar;
25. Raporti i Stresit për kapjen e sjellësit dërguar kancelarisë së princit;
26. Thashethemnaja për ngjarjen, për hetimet;
27. Biseda e Stresit me shokët e Konstandinit;
28. Mendimet e Konstandinit për Rendin e Ri të Arbrit;
29. Mbledhja e madhe në Manastirin e vjetër, fjalimi i kryepeshkopit dhe fjalimi i Stresit;
30. Mosparja e Stresit dhe martesë e një vajze larg, e një Doruntine të re.

5.4 RAPORTI I KOHËS DHE HAPËSIRËS ME PERSONAZHIN

Duke theksuar, me shqyrtime të argumentuara, se vlera më e madhe e letërsisë, në fakt, po kaq dhe e personazhit kadarean, është te teknika shkrimore dhe mjeshtëria në formatimin e tyre, është në stilin unikal se si ai ngjyrosi përmes tyre një realitet të zyrtar, të ndryshëm nga ai që ne kemi jetuar me një shije bashkëkohësie. Gjykoj se vlera e personazhit të tij, pra e shumicës së personazheve në tekstet romanore, qëndron kryesisht në *shpluhurosjen e antikës*. Duke shpluhurosur mitet, dramat, tragjeditë antike, në disa nga romanet e tij më të realizuar, Kadare, përmes personazhit të tij, mjeshtërisht ia mbërriti që të eliminonte distancën kohore dhe hapësinore; shtu këtu dhe rrethanat e përveçme, në të cilat jetoi personazhi, po ashtu, edhe një element tjetër thelbësor të romaneve të tij, KOHËN (dhe pse atij vetë i pëlqen të përdorë shprehjen “i pakohë”). Duke i njohur, përmes librash, leximesh dhe debatesh, por në mënyrë të veçantë, në atë botë që na e sugjeron autori me personazhet e tij të shumtë, gjykoj, bazuar në faktet reale dhe po kaq edhe në faktet letrare se, komunizmi ishte regjim që e shtypte kohën. Ai,

madje, jo vetëm në kuptimin metaforik e ndaloi kohën, prandaj” *personazhi kadarean paraqet një komponent thelbësor të poetikës së romaneve të Ismail Kadaresë*”.⁵⁴

Te romani “*Kush e solli Doruntinën*”, qysh në paratekst vihen re kërkesa të tjera, në raport me kohën diegjetike. Përshtypja që fitohet fillimisht, se koha e fiksionit është e atillë që mbahet në mend, që rikujtohet ose që rindërtohet, që është tipike për të kaluarën, vjen e përmbysset sapo t’ia vësh pranë indikatorët temporal historik. Në këtë roman, përmes **personazhit të Konstantinit**, koha e fiksionit dhe koha e narracionit, nuk mund të përkufizohen aspak brenda zhanrit të romanit të personazhit. Dëshmia e ngritur mbi besën-fjalën e dhënë, transponohet në të vërtetë universale, që nuk lidhet me ndonjë moment të caktuar nga jeta e personazhit, por me një kod kulturor të një etnike të tërë. Ajo ngrihet në simbolikë, ndërsa koha diegjetike e romanit, përpara se me atë historike, korrespondon me kohën biblike.

Nga studimet etimologjike, për fjalën “*besa*”, që lidhet më njëqind fije me personazhin e *Konstantinit* dhe për vlerat e saj semantike, dalin dy koncepte që mund t’i përmbledhim kështu: 1) është fjala për një akt, në të cilin “premtimi” shoqërohet detyrimisht me “zbatimin konkret” të tij; 2) “detyrimi”, është një kusht i nënkuptuar për subjektin e interesuar për rivendosjen e nderit të tij. Duke qenë normë zakonore, *besa*, si “fjalë e dhënë, premtim, besnikëri, armëpushim, marrëveshje”, hyn në një skemë logjike që udhëhiqet nga ligje të përcaktuara morale, të cilat kërkojnë gjithnjë një veprim të detyruar nga ana e subjektit të lidhur me *besë*. Ky karakter i detyruar i veprimit të personazhit, ka gjithnjë një zhvillim vertikal nëpërmjet një serie aktesh të njëpasnjëshme, që mund të arrijnë në dy përfundime: te *nderja*, pra te “nderi, te prestigji shoqëror i rifituar”, kur pikësynimi i besës arrin realizimin e tij konkret objektiv; te një përfundim i kundërt me të parin, pra te *pa-nderja*, te “çnderimi, te turpërimi shoqëror”, në rastin kur ky pikësynim nuk arrihet.

⁵⁴ Arlind Farizi, *Raporti i kohës dhe hapësirës me personazhin*, Filologjia | Vol. 7 | No. 11-12 | pp. 1-176 | Tetova | 2019, f.22

5.5 PERSONAZHI NË RAPORT ME HAPËSIRËN

Mjafton të nënvizojmë faktin se në romanin *Kush* e solli Doruntinën ku ai jep tërë katharzën e tij për “transformimin e kohës në hapësirë”: Pikërisht, ky roman në tërësinë e vetë, por edhe në morinë e elementeve thadruar të artit, edhe vërteton atë që thotë studiuesi kroat Ante Stamac se “kohën”, “*nuk mund sjellim në raporte kuantifikuese, diskontinuele, në thelb raporte hapësinore dhe shkak – pasojë që mund të interpretohen si pozitiviste nga se vepra është refleksioni i saj më i thellë*”.⁵⁵

Rolan Barthesi-i është i interesuar për relacionin *kohë-letërsi*. Ai shtron pyetjet: *Letërsia, si një e dhënë sociologjike, a është e lidhur me kontekstin kulturor? A ndryshon me epokat apo praktikatat poetike dhe a paraqet një aspekt transhistorik dhe jokohor?*⁵⁶

Bashkë me letërsinë e Kadaresë, edhe personazhi e aplikon reflektimin e kohës edhe atë, në dy aspekte:

- *Përmes temporalitetit të jashtëm, që ka të bëjë me datën e prodhimit të tekstit, me datën e publikimit të tekstit, si dhe me momentet e receptivit;*
- *Përmes temporalitetit të brendshëm, që ka të bëjë me kohën e veçantë të ngjarjes së rrëfyer, gjegjësisht, me kohën diegjetike.*⁵⁷

Aty, diku mes gjurmëve të këtij studimi, e mendova vetë projektin analizues, edhe si një sintezë të personazhit kadarean mes dy kohërave, që megjithatë, ndahen nga një meskohë e artë, herë-herë dhe e padiktueshme. Në kuptimin letrar, kjo rrethanë ka të bëjë me faktin se si është interpretimi i parë mbi personazhin, i kohës së monizmit, si fakt sociologjik, dhe personazhi në kohën e demokracisë, kryesisht si fakt letrar dhe tekstologjik. Kuptohet se, kjo tendencë e leximit dhe verifikimit të personazhit në dy kohë, mbase edhe duke ndryshuar jo pak nga metodologjia e shqyrtimit, nuk ka për qëllim t’i minimizojë dallimet ekzistuese, por me këtë qasje, vetëm sa dëshiroj që të tregoj ndikimin e ndërsjellë dhe të larmishëm të ideve, imazheve të ndryshëm, të

⁵⁵ Ante Stamac, *Ranjevi opis sustava* (Përshkrimi i dhembshëm i sistemit), Zagreb, 1996.f. ?

⁵⁶ Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AID, Prishtinë, 2011, f. 15.

⁵⁷ Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AID, Prishtinë, 2011, f. 17.

cilët dihet se, nëpër kohë të ndryshme, rrezatuan në mënyra të ndryshme...”*Në romanin e autorit - Kadare, mund të konstatojmë edhe një herë praninë e elementëve të poetikës së romanit realist, të ndërthurura lirshëm me elemente të poetikës së romanit modern apo, deri diku, edhe postmodern, por jo si eksperimentim apo shkëputje nga letërsia e tij e mëparshme, por si pohim dhe rrjedhë e natyrshme e shkrimit letrar në kushtet e rënies së pengesës së jashtme ideologjike, e cila në çfarëdo mënyre, rrudhte shprehjen artistike dhe domethëniet kuptimore.*”⁵⁸ Ky autor dëshmon kalimin e natyrshëm nga personazhi i para viteve ‘90, si një përvojë krijuese, që nuk tronditet tërësisht, por bën riparimet dhe përshtatjet e zakonshme për një shkrimtar.

Simboli i besës apo fjalës së dhënë është një nga figurat më prezente në veprën e Kadaresë. Përmes kësaj figure ai arrin të futet në pjesët më delikate të jetës së njeriut. Vetëm përmes kësaj gjuhe ka arritur që për mrekulli të flas edhe për gjërat më të marrëzishme dhe më të pabesueshme sepse vetëm gjuha e simbolit dhe fantazia e tij brilante lejojnë të kalojë kufijtë e jetës normale me ç’gjë arrin të kënaq “epshet” e tij të shkrimit. *“Është fuqia e gjuhës së simbolit që bën të mundshme përcimin e mesazhit nga pjesa e vetëdijshme në pjesën e pavetëdijshme të psikës njerëzore”*⁵⁹

Simbolik është vetë elementi i ringjalljes, që në të vërtetë na rikujton kalimin nga paganizmi në krishterizëm. Këtë e kuptojmë më së miri përmes fjalëve të kapiten Stresit, i cili në fund, tek flet për gjendjen e rëndë në botë, ku çdo ditë e më shumë formoheshin fe dhe sekte të ndryshme dhe duke qenë kështu fatit të Arbërit, ashtu si çdo populli tjetër i kanosej rreziku dhe duhej mprehur mjetet mbrojtëse që i posedon, e në qoftë se nuk i disponon duhet krijuar patjetër sepse ishte në pyetje fytyra e njeriut arbëresh përpara botës. Si do të etiketohej ai?

Duke u ndodhur përballë gjithë këtyre problemeve të kohës, Stresi shihte vetëm një zgjidhje. Sipas tij, ishte miti me të cilin Arbëri do t’u përshtatej maskave të kohës në mënyrë for male dhe jo ideologjike. Gjithashtu, *“nuk është e rastit që teksti i “Doruntinës” dëshmon se miti ruan një lidhje simbolike me festën e Rrëshanjave, pikërisht në episodin ku Stresi dhe ndihmësi i tij, ndërsa shkojnë në pallatin e Vranjave, në atë “shtëpi hijesh”, ku tashmë po japin shpirt*

⁵⁸Arben Prendi, *“Prije dhe dukuri te romanit bashkëkohor shqiptar”*, doktoraturë e mbrojtur në Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike Shkolla Doktorale e Studimeve Letrare, f. 100, (në dorëshkrim)

⁵⁹Basri Çapriqi, *Paradigma kadareane*, f. 40

*Doruntina dhe e ëma, hasin në ca fletëza trëndafili të bardhë, pra të lules që te romakët e lashtë simbolizonte kujtimin e të vdekurve.*⁶⁰

I vetmi dallim te Doruntina është koha. Festa e rrëshajave kremtohej në pranverë, atëherë kur edhe natyra ringjallej, njerëzit kremtonin duke i përkujtuar të vdekurit e tyre, sepse besonin që ata në njëfarë mënyre ringjallen dhe komunikojnë me to. Ndërsa, te Kadare është vjeshta stina e “shenjtë”, kur edhe ndodhin ngjarje jo të zakonshme. Një rast i tillë ishte “ringjallja e Konstandinit”. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët e kapiten Stresit cili thotë: “Kam vënë re se ngjarjet më të çuditshme ndodhin gjithmonë në vjeshtë”.

Te “Kush e solli Doruntinën” studiuesit dhe kritikët më shumë përqëndrohen të gjejnë simbolin kryesor të veprës. Për fjalën e dhënë, besën shqiptare ka dëgjuar pothuajse gjithkush. Ajo përbën zakonin, traditën dhe është një nga virtytet me të cilat karakterizohet shqiptari. Besa është vetëdija më e fortë, bindja dhe besimi i njehtë për të gjithë, qoftë i krishterë, qoftë mysliman besa kishte të njëjtën peshë. Dhënia e besës shoqërohej me shtrëngimin e duarve dhe shikimin sy më sy. Në rastin konkret autori e ngre shumë lartë besën. Fakt për këtë është vet simboli i ringjalljes së të vdekurit për të çuar në vend fjalën e dhënë. “*Për fuqinë simbolizuese të këtij virtyti të veçantë të shqiptarëve “Kush e solli Doruntinën” cilësohet ndër njëqind kryeveprat e letërsisë botërore*”⁶¹.

Një element tjetër me rëndësi në veprat e Kadaresë është grotesku, që autori e parapëlqen dhe e përdor gjerësisht nëpër veprat e tij. Përmes figuracionit të groteskut ai arrin të sqarojë edhe gjëra jo të zakonshme. Madje, “*grotesku është një nga mjetet më të fuqishme të artit që çjerr maskat e që paraqet dritën e vërtetë, shumë dukuri të realitetit, për të bërë ato zbulime, nga të cilat kanë frikë regjimet diktatoriale*”⁶²

Kadare është shkrimtari që vazhdimisht ka prekur me penën e tij ndodhitë më të mëdha të historisë së popullit shqiptar, ka prekur problemet e jetës, të vdekjes, të dashurisë, krimin, heronjve etj. Te “Kush e solli Doruntinën” gjithçka është bazuar nga legjenda e besës. Sipas Kadaresë, martesat e largëta kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe emancipimin shoqëror, prandaj, pasojat që sjellin këto martesë duket sikur autori deri diku i përligj. Përmes elementit të ringjalljes shohim që besën ta ngrejë shumë lartë, e konsideron si akt të shenjtë. Këtë e dëshmojnë vargjet:

⁶⁰Ismail Kadare, Vepra-10. f. 162

⁶¹Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, Tiranë, 2010, f.125

⁶²Alfred Uçi, *Grotesku kadarean*, Onufri, Tiranë, 2001, f 12

“Kemi parë, s’kemi parë
Shkon i vdekuri me të gjallë,
Hipur mbi të njëjtin kalë”⁶³

Grëfimi mbi udhëtimin e të gjallit me të vdekurin edhe njëherë na vë në dukje prezencën e groteskut të cilin Kadare e ka atë për qejfi. Gjithashtu, groteske është edhe vdekja e Doruntinës dhe Zonjës Mëmë, të cilat pësuan nga ngarkesa tragjike.

“ Rëndësia simbolike e historisë së Konstandinit qëndron në idenë e kalimit nga një botë në tjetrën. Figura e Konstandinit kryen disa funksione në veprat e Kadaresë, si djali besnik, luftëtari i ndershëm, mbajtësi i besës apo betimit, vëllai besnik që shpëton motrën e braktisur Doruntinën, fantazmë gotike që ngrihet nga varri, rrëzusi i tabuve dhe kalimtar mes dy botëve. Ai është vizitor prej një bote tjetër, asaj të vdekjes, historis së ëndrrave, i cili ashtu si fantazma e të atit të Hamletit, turbullon ndërgjegjen e të gjallëve. Vdekja Konstandinit është vdekje e letërsisë. Roli i Konstandinit në botën e muzgut të vdekjes e jetës është i dyfishtë. Ai është vizitor prej botës tjetër, roli i të cilit është të sjellë të vërtetën (realitetin) në përputhje me fjalët. Premtimi i tij, betimi apo besa, për të sjellë Doruntinën parathotë kthimin nga bota e nëndheshme dhe jo anasjelltas. Konstandini është imazhi i poetit dhe i lidhjes së thellë mes poezisë e jetës për shkrimtarin shqiptar” .⁶⁴

Konstandini zë vendin e heroit në vepër, madje në mbarë Shqipërinë, sepse ai është vetë simboli shqiptar, është fjala e dhënë, është besa, premtimi, ai është edhe ringjallja. Gjithë këto e etiketojnë Konstandinin, andaj sa herë që të flitet për besën, për fjalën e dhënë patjetër që do na kujtohet Konstandini, heroi i Kadaresë dhe i mbarë shqiptarisë.

Përmes kësaj legjende, Kadare pasqyron një nga virtytet më thelbësore të mashkullit shqiptar, i cili gjithmonë kur ka qenë nevoja është besatuar dhe ka mbajtur fjalën e dhënë. Askush më mirë se Kadare përmes Konstandinit nuk e tregon këtë. Ai madje shkon deri në majat më ekstreme të arsyes së një mendje të shëndoshë. Për shumëkënd mund të duket i çmendur ky shkrimtar, megjithatë, duket që mundësia për ta etiketuar si të çmendur si bëri përshtypje, andaj edhe e stërlodh personazhin e tij në varr duke mos e lënë të pushoj i qetë, deri

⁶³ Po aty, f. 143

⁶⁴Peter Morgan, *Kadare, Shkrimtari dhe Diktatura 1957-1990*, Tiranë, 2000 f. 186

në momentin kur e “detyron” të çajë dheun e të ngrihet për të kryer punën e lënë përgjysmë. Domethënë, është ringjallja, simboli i ringjalljes, një simbol mjaft i fortë, përmes, të cilit autori na tregon ne dhe gjithë botës se çdo të thotë kur jep besë shqiptari.

Ajo që e priti te dera të bijën ishte e ëma. Teksa po hapte derën e pyeti se kush e kishte sjellë. Kurse Doruntina që s’dinte për ndodhitë e vëllezërve të saj u përgjigj në mënyrë shumë normale; më solli im vëlla Konstandini. Mirëpo, në ato çaste përgjigja e Doruntinës vë në një gjendje kome nënë e bijë. Që të dyja tmerrohen nga fjalët e njëra tjetrës dhe shtrihen në shtrat për vdekje. Pas disa ditësh, kur gjërat qartësohen, sadopak, dhimbja u shtohet dhe më shumë, andaj që të dyja ndërrojnë jetë.

Personalisht, njerëzit që merren me shkrime çdoherë i kam llogaritu të “çmendur”. Kam bindjen që në çdo shkrim të tyre ekziston një çmenduri, një gjë e kotë që të torturon, të ngre nervat dhe të bën të lëshosh ofshama, e në fund të përplasësh librin duke lëshuar një mallkim për autorin, i cili nxjerr çmendurinë nga goja dhe si bëhet vonë si do ja bësh ti. Merru thotë ti, çaj kokën me veprën time të shenjtë. I çmenduri i rradhës për të cilin më ra hise të flas është pikërisht Ismail Kadare. Do thoshit juve ç’bëri ky njeri, ç’gjë të çmendur shkroi? Këtij iu te njëherë t’i marr shpirtin njërit nga personazhët e tij dhe pas një kohe s’di ç’dreq e gjeti, e pati për të na befasuar ne, apo mbase për të treguar që zotëron diçka, ”hyjnia” e tij i dha urdhër artit që ta ringjall atë. “Me ringjalljen” e Konstandinit trazoi i gjithë fshati. Gjithëkush interesohej të dijë diç më tepër rreth kësaj ngjarjeje të çuditshme. Aq i madh ishte interesi i tyre për të mësuar më shumë rreth ngjarjes sa të lente përshtypje se çdo mëngjes secili para se t’u grahte punëve që ka, ndërronte dy fjalë me fqinjin rreth problemit Konstantin-Doruntinë. Edhe mbrëmja i mblidhte njerëzit nëpër oda ku këmbeheshin informacione dhe sado pak shuhej kureshtja. Ishte absurde ngritja nga varri i një të vdekuri, aq më shumë, të ringjallet, të çojë amanetin në vend dhe përsëri të zhduket. Kjo ishte diçka që logjika njerëzore, sado që përpiqej se kuptonte dot.

Në zbulimin e këtij misteri ngarkohet kapedan Stresi. Ndërkaq kudo flitej se mes Doruntinës dhe të vëllait Konstandinit kishte pasur një dashuri inçesti, dashuri kjo që paska qenë e “aftë” të ngrejë nga varri të vdekurin. Të tjerë ishin të mendimit se Konstandini nga varri e kishte ngritur “besa” që i kishte dhënë së ëmës se do t’ia sillte të bijën kudo që ajo ndodhej.

Lidhur me këtë ndodhi ekzistonin mendime të ndryshme. Andaj autori mbase qëllimisht ka caktuar këtu Stresin, kinse zgjidhje e problemit. Duke qenë se bën hetime të thella, njerëzit e tij arrinë të kapin një njeri, i cili më shumë se çdokush i përshtatej ndodhisë. Megjithatë, sapo u

mendua se problemi zgjidhej, ai u ndërlikua dhe më shumë. I dyshuari nën shtrëngim të Stresit, pranon gjithçka. Shtrohet pyetja: u zgjodh vallë problemi? Fatkeqësisht jo! Jo që nuk u zgjodh, por u lidh dhe më shumë. Duke qenë se Stresi e vë nën tortura, ai zbulon se i dyshuari kishte shpikur historinë.

Duke parë situatën Stresi vendosi t'i jap fund këtij misteri. Ai caktoi mbledhjen e madhe, ku do të merrnin pjesë njerëz nga e gjithë rrethina, ku edhe do të zbulonte misterin. Mbledhja u mbajt në Manastirin e vjetër të qytetit, me praninë e arqipeshkvit dhe të fisnikëve të rrethinave. Mbretëronte heshtja. Stresi fillon të flas. Në fillim u tregon rrëfimin e njeriut të dyshuar, të cilin e zbulon që kishte qenë i shpikur. Tregon që ai njeri lëre që nuk e ka sjellë Doruntinën, por as nuk e ka njohur.

Me të përfunduar rrëfimin për njeriun e dyshuar ai vazhdon. "Doruntinën e solli Konstandini" Në këtë moment shkakton zhurmë që nënkuptonte mospajtim me atë që tha. Megjithatë vazhdon. Tregon për martesën e çuditshme të Doruntinës larg qytetit. Flet për besën që i dha Konstandini të ëmës se do i sjell të bijën sa herë të dojë, andaj i thotë, kjo ndodhi, ky udhëtim, nuk ka ndonjë shpjegim tjetër. Doruntinën e solli "besa" e Konstandinit, ndërsa pak rëndësi ka se në çfarë mënyre apo ç'kalorës e solli. E rëndësishme është që ajo u soll nga dikush, qoftë kjo edhe erë e fuqishme, ajo u soll, erdhi dhe besa e Konstandinit u mbajt, zuri vend.

E gjithë fabula në disa momente duket e palogjikshme. Duket e dhunshme. Të detyron të besosh në gjëra që s'do kishte besuar mbase asnjëherë. Por, duke përdorur fjalën e urtë të popullit, fantazinë, imagjinatën dhe talentin e vet, autori tregon për forcën, rëndësinë dhe vlerën që ka besa të shqiptarët.

Synimi kryesor i këtij punimi është të dallojë dhe të shpjegojë, duke nisur nga strukturimi i veçantë i raporteve të kundërtave të bashkëlidhura në konceptin e besës, mekanizmin e funksionimit të premisave rrëfyese të pranishme në veprën "Kush e solli Doruntinën" që e ndërton fabulën e saj pikërisht mbi "*fjalën e dhënë*". Prej tij është shkëputur një pjesë që, në një kreshendo kushtesh të sakta e të ndërlikuara të rrëfimit, e njihte "*Kush e solli Doruntinën*" të Kadaresë si një nga veprat më të arrira në planin semiologjik dhe imazhologjik të letërisë shqipe. Është fjala për një aspekt që jo vetëm nuk është i dorës së dytë në raport me temën qendrore të motivit të besës në romanin "Kush e solli Doruntinën", por i vështruar në optikën e një analize ndërtekstore. Nuk është e rastit që kush i ka kushtuar një vepër besës, përpara publikimit të dramës së Frashërit – letërsia gojore dhe Zef Skiroi, për shembull. – ka shfrytëzuar gjinitë letrare

në vargje; po kështu nuk është rastësi që kush u përqëndrua përsëri mbi të njëjtin motiv pas vitit 1875 – paradigma të shkëlqyera rrëfyese janë novela “Gjaku” e Ernest Koliqit dhe dy romanet “Kush e solli Doruntinën” e “Prilli i thyer” të Ismail Kadaresë –, nuk ka mundur të mos e konsiderojë si një subjekt topos me ato ndryshime të gjendjes tipike për romanin, pikërisht të asaj gjinie letrare evropiane, origjinën e së cilës M. Bahtin⁶⁵, në mënyrë gjeniale dhe absolutisht novatore, e gjen në evoluimin e idilit familjar. Modeli tregues i besës: një rreth digjetik i mbyllur. Nga studimet etimologjike për fjalën besa dhe për vlerat e saj semantike dalin dy koncepte që mund t’i përmbledhim kështu: është fjala për një akt në të cilin “premtimi” shoqërohet detyrimisht me “zbatimin konkret” të tij; “detyrimi” është një kusht i nënkuptuar për subjektin e interesuar për rivendosjen e nderit të tij. Duke qenë normë zakonore, besa, si “*ffalë e dhënë*, premtim, besnikëri, armëpushim, marrëveshje”, hyn në një skemë logjike që udhëhiqet nga ligje të përcaktuara morale, të cilat kërkojnë gjithnjë një veprim të detyruar nga ana e subjektit të lidhur me besë.

Ky karakter i detyruar i veprimit ka gjithnjë një zhvillim vertikal nëpërmjet një serie aktesh të njëpasnjëshme, që mund të arrijnë në dy përfundime: te nderja, pra te “nderi, te prestigji shoqëror i rifituar”, kur pikësynimi i besës arrin realizimin e tij konkret objektiv; te një përfundim i kundërt me të parin, pra te pa-nderja, te “çnderimi, te turpë- rimi shoqëror”, në rastin kur ky pikësynim nuk arrihet.

Procesi që shpie nga besa te nderja ndahet nga një moment ndërmjetës që sanksionon realizimin efektiv të së parës dhe përlij rinjohjen e së dytës: burrnisë, që është shfaqje e “guximit, e vlerës shoqërore” të atij që, duke mbajtur besën, e meriton nderjen. Shfaqja e burrnisë në përgjithësi përkon me një gjendje tjetër juridike, me gjakmarrjen, ose me “hakmarrjen”, që përbën gjendjen e mungesës fillestare nga e cila buron besa.

Zbatime koherente të këtij modeli tregues gjenden në letërsinë gojore: për shembull, në dy baladat Kostandini i vogël e Kostandini dhe Doruntina, struktura diexhetike e bazuar mbi një sekuencë të vetme, ndjek mekanikisht vijimësinë vertikale të parshikuar [(a) → (b) → (c)], duke mos e lejuar tregimtarin të ushtrojë lirinë e tij krijuese. Në të dyja baladat, heroit ndërmerr një veprim që nga (a) i lejon të arrijë në (c), por vetëm pas mënjanimi të pengesës së pranishme në (b). “Udhëtimi” i heroit (nga lufta në paqe; nga vdekja në jetë) përfaqëson provën që duhet

⁶⁵ Shih. M. Bahtin, “Formy vrenmeni i chronotopa v romane, in Voprosy literatury i estetiki, f. 343

kaluar për rivendosjen e ekuilibrit fillestar; kjo arrihet nëpërmjet realizimit të “premtimit” të heroit, pa të cilin i gjithë cikli tregues nuk do të kishte kuptim as logjik, as brendor.

Jemi përpara një balade sa të vjetër po aq të fuqishme, në zemrën e së cilës qëndron besa shqiptare virtyt ky që baladën e bën të madhërishme. Jemi dëshmitarë të faktit që këtë baladë e posedojnë popuj të shumtë, madje disa prej tyre, në mesin e të cilave edhe ne pretendojmë të jemi djepi apo vatra ku ka lindur kjo baladë. Madje flitet që populli ynë i ka gjasat më të mëdha për të qenë ëma e gjithë motërzimeve tjera, në mos e ëma, motra e madhe me siguri.

Duke qenë se pretendojmë të jemi të parët e kësaj balade atëherë patjetër që edhe kemi një hak ndaj saj. Duhet dalë zot dhe, askush më mirë se Kadare nuk i doli zot kësaj detyre. Për të kjo nuk ishte vetëm obligim, ishte edhe privilegj. Edhe pse të shumtë do të ishin ato që do kishin dashur të kenë këtë privilegj duhet ditur që nuk mjafton vetëm dëshira, nevojitet talenti dhe pena e mprehtë, siç është ajo e Kadaresë, e cila nga një baladë nxjerr një roman.

Fansat e tij, njerëzit që i kanë ndjekur hapat që i bën ai, me siguri prej kohe kanë ndjerë aromën e kësaj novele. Edhe pse kritika nuk e priti aspak mirë, disa thoshiin që duhet të kishte qenë më afër baladës, kishin shpifje që shkrimtari ka dalë pak nga kornizat e saj, ca të tjerë e thoshin të kundërtën, kështu që romani në përgjithësi në atë kohë s’u prit aspak mirë, madje rrezikohej të mos pranohej. Megjithatë, për dallim nga kritika mendimi i lexuesit rezulton të jetë pozitiv. Por, si do që të jetë mendimi i kritikës dhe i lexuesit, shtrohet pyetja: Cili ishte qëllimi që autori e shkroi këtë vepër dhe ç’vlera sjell ajo?

Romani është dëshmi e gjallë që ai përmes tij ka dashur nga balada të nxjerr një prozë realiste, të cilën do ta shijojë edhe ai lexues që s’di se ka ekzistuar balada. Pra, autori ka për qëllim që vepra e tij të ketë në zemër baladën, por të qëndroj këmbë më vete e të duket e pavarur; andaj për të arritur gjithë këtë ai padyshim ka vënë në funksion imagjinatën dhe talentin që ka. Këtu bëjnë pjesë parashtrimi i kushteve historiko-shoqërore kur lindi ajo dhe më kryesorja, se lindi ajo, meqë balada është protest kundër egzogamisë, e cila nënkupton rregull kulturore, që ndalon martesën brenda grupit farefisnor. Megjithatë, incesti apo ekzogamia në roman qëndrojnë vetëm si pretekst. Edhe po të mos ishte incesti do të ishte diçka tjetër. Thelbi i saj është fjala e dhënë, besa. Prandaj autori më shumë kujdes i ka kushtuar Konstandinit dhe fjalës së tij.

Përmes këtij romani autori nxjerr në pah një ndër virtytet më të bukura që ka pasur dhe ka populli ynë. Përmes Doruntinës përforcon atë që ka thënë te “Prilli” aty ku besën e paraqet si

rregull juridike. Tani me Doruntinën përmes veprimit të ngritjes nga varri të Konstandinit do të tregojë sa e bukur dhe sa e tmerrshme njëkohësisht është besa shqiptare.

Përfundimi

Studimi i Kadaresë, romaneve të tij, koncentrisht romanit "*Kush e solli Doruntinën*", që ndërmarrje e rëndë për studim, sepse aty u pleksën një numër i madh temash, hipotezash, dilemash, për të mos dhënë madje dhe më këtë studim, të vërtetë përfundimtare. Romanet e tilla janë sistem të hapura dhe përherë sjellin këndvështrim të reja.

Faqet e fundit të romanit, ku Kadareja përshkruan vërbërinë e nënës nga pritja kanë një fuqi magnetike të papërballueshme nga askush. Pritje dhe mall Penelope... Mund të jenë ndër faqet më të bukura që kam lexuar në jetën time. Një epitaf lirik i jashtëzakonshëm si i skalitur në bronx.

Romani '*Kush e solli Doruntinën*' para se të gjithash ka qenë një legjendë e thjeshtë e dalë nga goja e popullit, që më pas është kënduar, recituar, shkruar e stërshkruar. Tani ndodhemi përpara një romani misterioz që në vete përmban shumë polemika. Në fakt që në fillim ka qenë i tillë, i fshehtë, misterioz. Në shikim të parë duket që romani përmban një subjekt të thjeshtë. Na flet për një grua të hipur mbi kalë, e cila kishte marrë rrugën për t'u kthyer në fshatin e saj. Gjithçka rreth saj është mjaft e errët. E kishte sjellë në mes të natës kalorësi misterioz për të cilin flitej se ishte i vëllai i vogël që kishte vdekur para disa kohësh.

Doruntinën e solli fjala e dhënë, thotë kapiteni Stres që kryeson hetimet. Doruntinën e solli besa shqiptare, nxitojnë moralistët. Doruntinën e solli pengu i incestit të pakryer, thonë psiko-kritikët. Doruntinën e solli një aventurier dashurie, një "dikush" i rastit, pohon njëri prej priftërinjve. Nëse në të gjitha këto pohime ka diçka prej së vërtetës, mbetet pa u thënë thelbi: Doruntinën e solli Rilindja, era e furishme e ndryshimeve të saj, tronditja e moralit të Mesjetës dhe kërkimi i një dhjate të re humaniste, rebelimi i mendjeve të fuqishme të kësaj epoke për t'i dhënë njeriut kuptim sublim; përpjekja e tyre për t'u bërë zotër të vetes, për të mbërritur te shën Njeriu.

Atributi i ringjalljes, kësaj radhe nuk ndodh në versionin biblik, por sipas një balade laike të vendit. Kostandini është, në mënyrën e vet, një Mesi për bashkatdhetarët. Ai mbërriti të parralizueshmen dhe u afroi njerëzve madhështinë: kthimin nga vdekja, mundjen e saj, qoftë edhe në formë të reduktuar. Fryma e rilindjes dhe shpresa e përtëritjes kanë krijuar historikisht

energji shpirtërore të mëdha. Kadareja ekspozoi një nënshtat krejt të rnostpërfillur të kulturës kombëtare. Legjenda e Doruntinës nuk ishte "punë legjendash", por konkluzion i një epoqe historike. Ajo shpallte lidhjet e lashta të kulturës së popullit tonë me ato të vendeve të qytetëruara të kontinentit.

Në më pak se 50 vargje të parët e shqiptarëve jepnin e merrnin me një botë të tërë, bënin krushqi gjer në Bohemi, lidhnin aleanca me baronë e fisnikë të afërt e të largët, lëviznin të sigurt në gjithë hapësirën kontinentale. Ata ishin pjesë integrale e kësaj bote. Miqësitë e tyre gjendeshin "nëntë male kapuarë". Të shkoje në viset gjermane apo dhe më tej për ta ishte njësoj si të thoshje: "po shkoj në krushqi". Në Shqipërinë e mbyllur, pa një mik, pa një aleancë, pa një portë të hapur, të fundit të viteve '70, kjo ekspozë mund të ngjallte zemërime e pakënaqësi, mund të shkaktonte inate e mëri.

Novela predikonte hapjen, kur politikanët kërkonin mbylljen. Autori u paraqiste si shembull humanizmi bashkatdhetarëve të vet lashtësinë e tyre, kur në vend zotëronte një pikëpamje çuditërisht e ngulitur, sipas së cilës vlerat e vërteta ishin krijuar në gjysmëshekullin e fundit.

Bibliografia:

Vepra me poezi

Ismail Kadare, *Frymëzime djaloshare*, Tiranë, 1954.

Ismail Kadare, *Shekulli im*, Tiranë, 1961.

Përmbledhje tregimesh

Ismail Kadare, *Gjakftohtësia*, Tiranë, 1980.

Ismail Kadare, *Ikja e shtergut*, Tiranë, 1999.

Ismail Kadare, *Vjedhja e gjumit mbretëror*, Tiranë, 1999

Romane

Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare *Koncert në fund të dimrit*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Dimri i vetmisë së madhe*, Tirana, 2010

Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Kështjella*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Qorrfermani*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Pallati i ëndrrave*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Darka e gabuar*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *E penguara*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Aksidenti*, Tiranë, 2010

Ismail Kadare, *Mosmarrëveshja*, Tiranë, 2010

LITERATURA

1. Aristoteli: *Kategoritë*, Rilindja, Prishtinë, 1987
2. Aristoteli: *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1998
3. *Artikuj dhe studime mbi romanin*, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë, 1980
4. Aurbah, Erih: *Mimesis*, Nolit, Beograd, 1978
5. Bachtin, M. "Formy vrenmeni i chronotopa v romane, in Voprosy literatury i estetiki, 2000
6. Bahtin, Mihail: *Problemi poetike Dostojevskog*, Nolit, Beograd, 1967
7. Bahtin, Mihail: *Stvaralastvo, Fransoa Rable*, Nolit, Beograd, 1978
8. Bahtin, Mihail: *Teorija romana*. Ljubljana, 1982.
9. Barthes, Roland: *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008
10. Barthes, Roland: *Aventura semiologjike*, Prishtina, 1972
11. Beker, Miroslav: *Suvremene književne teorije*, MH, 1999.
12. Berisha, Anton: *Mundësi interpretimi*, Prishtinë, 1979
13. Bokaçio Xhouvani, (1993), Dekameron I, Tiranë,
14. Bosquet, Alaian *Himn i shumëkuptimshmërisë* Revista letrare „*Jeta e re*“, nr 2, viti XLII, Prishtinë, 2011,
15. Çabej, Eqrem: "Për gjenezën e literaturës shqipe", Tiranë, 1937
16. Çapaliku, Stefan: *Estetika moderne*, SHBLU, Tiranë, 2006
17. Çaushti Tefik, Kadareja përmes pasqyrave, Tiranë, 2010.
18. Çaushti, Tefik: *Fjalor i estetikës*, Ombra GVG, Tiranë, 2005
19. Chevral, Iv: *Letërsia e krahasuar*, Albin 2002, f. 28
20. Çiraku, Ymer, *Gjurmime në letërsinë shqiptare*, Albas, Tetovë. 2010
21. Coelho Paulo, *Alkimisti*, Botimet TOENA, Tiranë, 2004
22. Dado Floresha: kumtesa "Probleme metodologjike të letërsisë së sotme
23. Dado, Floresha: *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006

24. Dado, Floresha: *Poetika*, SHBLU, Tiranë, 1999
25. Eko, Umberto: *Gjashtë udhëtime në pyjet narrative*, Asdreni, Shkup, 1997(përktheu Bujar Hoxha)
26. Eko, Umberto: *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007
27. Eko, Umberto: *Si bëhet një punim diplome*, Tiranë, 2006
28. Eko, Umberto: *Struktura e papranishme*, Pejë, 1996
29. Eko, Umberto: *Të thuash gati të njëjtën gjë*, Tiranë, 2006
30. Faji John Green në yjet tanë, UEGEN, Tiranë, , 2014
31. Farizi, Arlind *Raporti i kohës dhe hapësirës me personazhin*, Filologjia | Vol. 7 | No. 11-12 | pp. 1-176 | Tetova | 2019
32. Fetiu, Sadri: *Romani shqiptar i luftës*, Rilindja, Prishtinë, 1979
33. Fraj, Northrop: *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990
34. Hamiti, Sabri: *A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit*, Rilindja, Prishtinë, 1982
35. Hamiti, Sabri: *Albanizma*, ASHAK, Prishtinë, 2009
36. Hamiti, Sabri: *A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit*, Prishtinë, 1982
37. Hamiti, Sabri: *Bioletra, Faik Konica, Prishtinë, 2000*
38. Hamiti, Sabri: *Letërsia modern shqiptare, Prishtinë, 2000.*
39. Hamiti, Sabri: *Tematologjia, ASHAK, Prishtinë, 2005*
40. Hamon, Philippe, *Pour un statut sémiologique du personnage*, in R. Barthes, È. Kayser, È.C. Booth & Ph. Hamon, Poétique du récit. Paris : Seuil, coll. "Points Essais", 1977, p. 115-180 (version remaniée de l'article publié en 1972 dans Littérature, 6, Paris).
41. Hartman, Nikolaj: *Estetika, Kultura, Beograd, 1968*
42. Haus, Hans Robert: *Estetika recepcije (izbor studija)*, Nolit, Beograd, 1978
43. Historia e letërsisë shqipe të realizmit socialist, ASHASH, Tiranë, 1978
44. Hygo, Viktor, *Të mjerët III*, Rilindja, Prishtinë, 1985
45. Ismaili Rifat: *Poetika e prozës së Jakov Xoxës*, Rilindja, Prishtinë, 1991
46. Jefferson, An & Robei David: *Teoritë modern letrare*, Tiranë, 2004.
47. Johan Eölgang Gete, *Fausti*, Rilindja, Prishtinë,

48. Kadare, Ismail *Poezia është e pranishme kudo*. Intervistë dhënë revistës "Ylli", Tiranë 1979,
49. Kant, Immanuel: *Kritika e gjykimit*, Тирана, 2002.
50. Kohan, P.S.: *Historia e letërsisë antike greke*, "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 1990.
51. Koliqi, Ernest: *Kritika dhe estetika*, Tiranë, 1999.
52. Krasniqi, Bajram: *Kode të zhvillimit letrar*, Rilindja, Prishtinë.
53. Krasniqi, Dr. Bajram: *Poetika e romanit historik shqiptar*, Instituti Albanologjik I Prishtinës, Prishtinë, 1985
54. Krifca, Mirlinda. *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave botërore*,
55. Kundera, Milan. *Lehtësia e papërballueshme e qenies*, Albin, Tiranë, 1997
56. Kundera, Milan: *Arti i romanit*, Tiranë, 2001.
57. Kundera, Milan: *Уметноста на романот*, Култура, Скопје, 1990
58. Kuteli, Mitrush. *Tregime të moçme shqiptare*, Çabej & Feniks, Tetovë, 2003f
59. Liotar, Fransoa: *Gjendja postmoderne*, Prishtinë, 1997.
60. Mekuli, Hasan: *Romani shqiptar* (Kritikë dhe vështime), Prishtinë, 2000
61. Morgan Peter, *Kadare, Shkrimtari dhe Diktatura 1957-1990*, Tiranë, 2000
62. Parandovsky, Jan: *Alhemija rijeci*, Beograd, 1964
63. Peleš Gajo: *Tumacenje romana*. Zagreb: ArTresor naklada, 1999.
64. Pobrić, Edin: "Ritam romana", Polja, br.442, novembar - decembar 2006.
65. Pozzato, Maria Pia: *Semiotika e tekstit*, SHBLU, Tiranë, 2005
66. Prendi, Arben "Prije dhe dukuri te romanit bashkëkohor shqiptar", doktoraturë e mbrojtur në Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike Shkolla Doktorale e Studimeve Letrare,
67. Qosja, akad. Rexhep: *Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne*, USHT, Tetovë, 2007
68. Qosja, Rexhep: *Kontinuitete*, Prishtinë, 1972
69. Qosja, Rexhep: *Semantika e ndryshimeve historike-letrare*, Instituti Albanologjik: Prishtinë, 2009
70. Revista letrare, **Jeta e re**, nr 2, viti XLII, Prishtinë, 2011

71. Rugova, Ibrahim: *Kritika letrare*, Prishtinë, 1980
72. Rugova, Ibrahim: *Refuzimi estetik*, Prishtinë, 1987.
73. Rugova, Ibrahim: *Strategjia e kuptimit*, botimet Hejza, Rilindja, Prishtinë, 1980
74. Sapir, Eduard: *Hyrje në studimin e ligjërit*, Rilindja, Prishtinë, 1980
75. Shala, Demush .*Letërsia popullore*, Rilindja, Prishtinë, 2002,
76. Shala, Kujtim: *Shekulli i letërsisë shqiptare*, Tiranë, 2004.
77. Sinani, Shaban. *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, , 2009,
78. Sinani, Shaban: *Prurjet kulturore orientale*, Albas 2007 f. 43
79. Sopaj, Nehas: *Rrëfimi në romanin shqiptar*, Shkupi, Shkup, 1996
80. Sopaj, Nehas: *Rrëfimi në romanin shqiptar*, Shkupi, Shkup, 1996
81. Syla, Sulejman: *Interkomunikimi letrar*, Rilindja, Prishtinë, 1990
82. Tevo, P. & Lekont, ZH.: *Komenti letrar*, Uegen, Tiranë, 2000
83. Todorov, Cvetan: *Letërsia në rrezik*, Buzuku, Prishtinë, 2008
84. Todorov, Cvetan: *Poetika e prozës*, Tiranë, 2000
85. Uçi, Alfred: *Estetika, jeta, arti*, Tiranë, 1970
86. Uçi, Alfred: *Probleme të estetikës*, Rilindja, Prishtinë, 1980
87. Uelek, Rene; Ostin, Ueren: *Teoria e letërsisë*, Tiranë 1993
88. Uzeiri, Ilir: *Poetika*, Tiranë, 2000
89. Vinca, Agim: *Alternativa letrare shqiptare*, Shkup, 2005
90. Vinca, Agim: *Fije të pakëputura*, USHT, Tetovë, 2007
91. Visoka Avdi, *Koha e shkrimit*, 99-AID, Prishtinë, 2011
92. Zheji, Gjergj: *Artisti dhe jeta*, Tiranë, 1973
93. Zhenet, Zherar: *Figura*, Rilindja, Prishtinë, 1985
94. Zhiku, Ali: *Letërsia shqipe si polifoni*, “Dituria”, Tiranë, 2004

PËRMBAJTJA:

Contents

ABSTRAKTI NË SHQIP	2
ABSTRACT	2
HYRJE	3
LËNDA E HULUMTIMIT	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	8
HIPOTEZAT	9
METODAT E PËRDORURA PËR HULUMTIM	10
RËNDËSIA E PUNIMIT	11
KREU I PARË	12
I. KUSH ËSHTË ISMAIL KADAREJA – PORTRITI LETRAR	12
KREU I DYTË	15
II. RIKTHIMI I MITIT TE KADAREJA – “KUSH E SOLLI DORUNTINËN”	15
2.1 ÇKA NË TË VËRTETËËSHTË MITI, MITI LETRARE, RISEMANTIZIMI I MITIT	16
2.3 SI STUDIOHEN MITET?	17
2.4 MITI TE KUSH E SOLLI DORUNTINËN?	18
2.5 MITI RELIGJIOZ DHE MITI LETRAR	20
KREU I TRETË	25
III. NGJASHMËRI DHE DALLIME MES BALADËS SË RINGJALLJES TË LETËRSISË GOJORE ARBËRESHE DHE ROMANIT “KUSH E SOLLI DORUNTINËN”	25

3.1 SEMANTIKA E BESËS, <i>FJALËS SË DHËNË E TË MBAJTUR</i>	31
3.2 NDËRTHURJA E SUBJEKTIT TË KËTIJ ROMANI	37
3.3. KUSH E SOLLI DORUNTINËN?!.....	40
3.4 RINGJALLJA DHE KULTI I BESËS (ANALIZË NDRYSHE).....	41
KREU I KATËRT.....	43
IV. KATEGORIZIMI I PERSONAZHEVE DHE SPECIFIKAT E TYRE.....	43
4.1 PERSONAZHI NARATOR	46
KREU I PESTË.....	48
V. ENIGMA DHE DILEMA MITIKE.....	48
5.1 ÇKA INVESTIOGONTE KAPITEN STRESIT?	56
5.2 NDËRTEKSTORIA SI VLERË E ROMANIT MODERN.....	57
5.3 STUDIMI I VEÇANTË PERSONAZHIT TË STRESIT.....	57
5.4 RAPORTI I KOHËS DHE HAPËSIRËS ME PERSONAZHIN	59
5.5 PERSONAZHI NË RAPORT ME HAPËSIRËN.....	61
PËRFUNDIMI	70
BIBLIOGRAFIA:	72
LITERATURA	73
PËRMBAJTJA:.....	77